

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5902
E shtunë, 12 tetor 2019
çmimi 0.40 €

LDK-ja ndërpret
bisedimet me
Vetëvendosjen, pret
certifikimin e rezultatit
zgjedhor | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", JETA KRASNIQI | FAQE 4-5



KOSOVA DUHET TË NDËRTOJË QËNDRIM TË QARTË DHE UNIK PËR DIALOGUN

Menaxherja e projektit për dialogun Kosovë - Serbi në Institutin Demokratik të Kosovës (KDI), Jeta Krasniqi, ka thënë se qeverisë së re i mbetet që ta ndërtojë konsensusin e nevojshëm nacional për dialogun

Kosovë - Serbi. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ajo ka deklaruar se tani pala e Kosovës duhet të ndërtojë një qëndrim të qartë dhe unik për këtë çështje. Sipas saj, përfaqësuesi special i presidentit

amerikan për dialogun Kosovë - Serbi do të përpiqet që t'i kthejë palët sa më parë në tryezën e diskutimit, duke investuar fuqinë e tij politike për arritjen e marrëveshjes përfundimtare

Analistët: Qeverinë e re e presin shumë sfida

Njohësit e proceseve politike, Imer Mushkolaj dhe Artan Murati, kanë vlerësuar se qeveria e re do të përballet me sfida të shumta dhe të rënda. Ata kanë thënë për gazetën "Epoka e re" se sundimi i ligjit, zhvillimi ekonomik, përmirësimi i gjendjes në arsim dhe shëndetësi do të jenë sfidat kryesore në aspektin e brendshëm. Por, sipas tyre, kryesfidë do të jetë arritja e marrëveshjes përfundimtare me Serbinë. Ndërsa sa i përket Kuvendit, bazuar në rezultatet preliminare, Mushkolaj dhe Murati presin përbërje më të mirë të legjislaturës së shtatë



Veseli
paralajmëron
opozitë
të fortë



41 PERSONA DYSHOHEN SE
KANË KRYER VEPRA PENALE
GJATË PROCESIT ZGJEDHOR

F. 6

EKONOMI

ÇMIMET E KONSUMIT
PËSOJNË RËNIE TË LEHTË
NË SHTATOR F. 9

BANKA BOTËRORE NUK
PARASHEH RITJE EKONOMIKE
QË UL PAPANËSINË F. 9

KULTURË

'LIRIJA', GAZETA E RIBOTUAR
PAS NJË SHEKULLI F. 18

Mehdi GURRA

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI

www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Vuçiqi: Askush nuk po na ofron ndarjen e Kosovës

Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, tha se "askush nuk na ofron asgjë në lidhje me Kosovën, nuk ka ofertë për ndarje të Kosovës dhe se rreth 100 vende që e kanë pranuar Kosovën, nuk do të tërhiqen nga vendimi".

Këto vende, sipas tij, duan ta shohin Serbinë pa Kosovën.

Vuçiqi deklaroi, gjatë një vizite në një qytet të Serbisë, se "duhet kuptuar peshën e pozicionit të Serbisë" dhe se "nuk duhet gënjer popullin". "Të gjithë kanë

thënë se jam i gatshëm të nënshkruaj. Çfarë të nënshkruaj kur nuk ka asgjë", ka deklaruar presidenti serb.

Megjithatë, ai përsëriti se askush nuk e dëshiron kompromisin të cilin ai e ofron dhe se këtë kompromis e ka refuzuar edhe fituesi i zgjedhjeve në Kosovë, Albin Kurti.

Vuçiqi nuk bëri të ditur se për çfarë kompromisi bëhet fjalë.

Deklaratat e presidentit serb bëhen pas vizitës në Prishtinë dhe Beograd të të dërguarit pres-

idencial të ShBA-së, për bisedimet e paqes me Kosovës dhe Serbisë, ambasadorit Richard Grenell. "Qëllimi i tij është për t'i bërë bashkë partnerët tanë në Serbi dhe Kosovë, për një zgjidhje gjithëpërfshirëse për pikat e konfliktit në rajon. Të dyja palët do të duhet të punojnë ngushtë dhe shpejt, duke shikuar nga e ardhmja", është thënë në deklaratën e Ambasadës Amerikane në Prishtinë, e cila është lëshuar pas vizitës së ambasadorit Grenell.



Veseli paralajmëron opozitë të fortë

Kadri Veseli ka thënë se PDK-ja do të jetë opozitë e vërtetë kundër një kaste që veten e sheh mbi interesin e Kosovës dhe qytetarëve tanë dhe nuk do të lejojë dëmtimin e Kosovës në arenën ndërkombëtare duke i mbrojtur orientimet strategjike me ShBA-në dhe Bashkimin Evropian



EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 11 TETOR - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, ka thënë se sot, 20 vjet më pas, Partia Demokratike, trashëgimtarja e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, u soll denjësisht, transformoi veten dhe Kosovën. "Kur askush nuk priti, pasi iu nënshtruam proceseve demokratike, me dinjitet pranuan humbjet politike të brendshme, pas fitoreve në betejat luftarake me Serbinë. Por, PDK-ja nuk shkatërroi asgjë. Ne gjetëm forcën e konsolidimit të brendshëm, morëm përgjegjësitë e mëdha për vendin në procesin e negociimit për të ardhmen e vendit tonë. Qytetari e vlerësoi këtë, mirë dhe drejt. Pas tetë vjetësh, Partisë Demokratike qytetarët ia besuan drejtimin e vendit. Duke shënuar etapën e shtetësisë, shtetndërtimit dhe konsolidimit institucional, financiar dhe demokratik të Republikës së Kosovës. Duke shënuar etapën e ndryshimeve rrënjësore ekonomike, sociale, infrastrukturore. Duke e bërë Kosovën një dekadë shtet, të

barabartë me vendet e rajonit. Të gjitha këto të arritura mbajnë vulën e PDK-së", ka thënë Veseli me rastin e 20-vjetorit të themelimit të PDK-së.

Ai ka theksuar se gjatë rrugëtimit të tyre, për fat të keq, nuk u shpëtuuan edhe gabimeve. "Megjithatë, për dallim nga të tjerët, ne nuk heshtëm, vepruam. Nisëm përmirësimin e tyre dhe vendosëm një standard të ri etik në politikën kosovare. Për ta ndryshuar Kosovën, e nisëm ndryshimin nga vetja. Dhe, kjo qasje u përfaqëua nga të gjithë, nga baza jonë elektorale më së shumti. Për këtë, jam shumë, shumë krenar me ta dhe shumë mirënjohës!", ka thënë Veseli, derisa fjalimin e tij e ka vazhduar me zgjedhjet e 6 tetorit. "Gjatë këtyre javëve të fundit kemi punuar shumë për t'i fituar këto zgjedhje. Me projektin për një Kosovë perëndimore, pa korrupsion dhe nepotizëm dhe të zhvilluar ekonomikisht. I jam mirënjohës secilit prej jush, strukturave të palodhura dhe aktivistëve plot energji, për përkushtimin e treguar gjatë gjithë këtyre ditëve. Ne bëmë një fushatë konkrete, në sfidat që ka vërtet Kosova. Ndërsa

oponentët tanë u morën veç me ne. Ata arritën të bashkohen kundër nesh dhe ta ndërtojnë kauzën kundër nesh. Ne tani jemi opozitë! Do të jemi opozitë e vërtetë kundër një kaste që veten e sheh mbi interesin e Kosovës dhe qytetarëve tanë. Do të jemi opozitë në shërbim të Kosovës dhe vetëm të Kosovës", ka theksuar Veseli, duke shtuar se PDK-ja nuk do të lejojë me asnjë çmim të dëmtohet stabiliteti i Kosovës. "Ne nuk do të lejojmë cenimin e mirëqenies dhe të drejtat e secilës kategori të shoqërisë sonë. Ne nuk do të lejojmë dëmtimin e Kosovës në arenën ndërkombëtare dhe do t'i mbrojmë orientimet strategjike me Shtetet e

Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimin Evropian. Për Kosovën, s'ka veri dhe jug, s'ka asociacion me kompetenca ekzekutive dhe s'ka cenim të territorit. Çdo lëvizje nga këto parime, do ta ketë përgjigjen e drejtë dhe të vendosur nga ne. Ka vetëm një Kosovë unike, të mirëqenë, stabile, të respektuar dhe të fortë", është shprehur ai. Veseli ka thënë se ky 20-vjetor shënon fillimin e një epoke të re për Partinë Demokratike të Kosovës. "Një epokë me qasje të re, me ofertë të re, që u përgjigjet nevojave të Dekadës së Re. Tani, të dashur kolegë, na pret një betejë e re. Kosova ka nevojë për ne. Kosova, më shumë se kurrë, ka

nevojë të mbrohet nga mashtrimet dhe mashtruesit. Nga ata që nuk e njohin vlerën dhe sakrificën dhe manipulojnë me vlerat - të cilat i ndërrojnë varësisht nga pozita që kanë. Sado që ata të gabojnë dhe dështojnë, rreziku i madh për të gjithë është ecja prapa nga ajo që kemi arritur. Ne nuk do të lejojmë kurrë që të gabojë dhe të dështojë Kosova. Andaj, ju ftoj sot që ta merrni seriozisht këtë mesazh, sepse nuk bëhet fjalë vetëm për një garë, por kemi të bëjmë me diçka më të thellë dhe më të rëndësishme për shtetin tonë. Tani është edhe momenti i hapjes së madhe të Partisë Demokratike", ka deklaruar Veseli.

Çekia nuk ndryshon qëndrimin ndaj pavarësisë së Kosovës



PRAGË, 11 TETOR - Zyrtarët më të lartë kushtetues të Çekisë refuzuan propozimin e presidentit Miloš Zeman për tërheqjen e njohjes së pavarësisë së Kosovës. Presidenti çek tha, më 11 shtator në Beograd, se do të diskutojë me ekspertët kushtetues të vendit të tij, për mundësinë e tërheqjes së njohjes së pavarësisë së Kosovës, një

veprim që nuk përkon me postin kryesisht ceremonial të tij. Ai e shtroi këtë çështje në një takim të zyrtarëve më të lartë kushtetues në mesin e të cilëve janë presidenti, kryeministri, kryetarët e dhomave të parlamentit, ministri i Jashtëm, ai i Brendshëm dhe i Mbrojtjes. Ministri i Jashtëm çek, Tomas Petricek, tha se ishte përfundim i

takimit që qëndrimi i Republikës Çeke kundrejt Kosovës nuk ka ndryshuar.

Deklaratat e bëra në Beograd nga presidenti 74-vjeçar, që është i njohur për qëndrime kundërthënëse, kishin nxitur reagime në Çeki, ku idetë e tilla ishin cilësuar joreale.

Çekia e ka njohur Kosovën në maj të vitit 2008.

Njohësit e proceseve politike flasin për krijimin e qeverisë së re dhe sfidat që e presin

Analistët: Qeverinë e re e presin shumë sfida

Njohësit e proceseve politike, Imer Mushkolaj dhe Artan Murati, kanë vlerësuar se qeveria e re do të përballet me sfida të shumta dhe të rënda. Ata kanë thënë për gazetën "Epoka e re" se sundimi i ligjit, zhvillimi ekonomik, përmirësimi i gjendjes në arsim dhe shëndetësi do të jenë sfidat kryesore në aspektin e brendshëm. Por, sipas tyre, kryesfidë do të jetë arritja e marrëveshjes përfundimtare me Serbinë. Ndërsa sa i përket Kuvendit, bazuar në rezultatet preliminare, Mushkolaj dhe Murati presin përbërje më të mirë të legjislaturës së shtatë



EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 11 TETOR - Analisti politik Imer Mushkolaj ka thënë të premten për gazetën "Epoka e re" se Qeveria e re e Kosovës do të ketë shumë sfida para vetes. Ai ka theksuar se edhe pritjet e qytetarëve janë të mëdha sa i përket zgjidhjes së problemeve nga qeveria Kurti. "Qeveria e re do të ketë shumë sfida dhe përnjëmend është vështirë të bëhet një listë në kuptimin se cila është më e vështirë dhe cila më e lehtë për shkak se qeverisjet e kaluara në përgjithësi kanë krijuar shumë probleme dhe qytetarët i kanë pritjet e mëdha se qeveria e re e drejtuar nga Kurti mund t'i zgjidhë ato", është shprehur Mushkolaj, duke shtuar se një prej sfidave kryesore mbetet sundimi i ligjit, zhvillimi ekonomik, arsimit dhe shëndetësia. "Sfidat më të mëdha kanë të bëjnë me sundimin e ligjit. Këtu nënkuptoj luftimin e korrupsionit, krimin e organizuar dhe gjithçka tjetër që ka të bëjë me paligjshmërinë që është instaluar me vite në vend. Sfida e dytë do të jetë zhvillimi ekonomik, përkatësisht krijimi i mundësisë për hapjen e vendeve të reja të punës. Këtu po e ndërlihd edhe një sfidë që ka të bëjë me shëndetësinë dhe arsimin për shkak se të dy këto fusha kanë qenë të lëna anash deri më tash, ose më tepër kanë qenë prioritete në letër sesa që vërtet dikush është marrë me të seriozisht", ka deklaruar

Mushkolaj.

Ai ka thënë se sfida më e madhe mbetet arritja e marrëveshjes në mes të Kosovës dhe Serbisë. Anëtarët e LV-së dhe LDK-së për t'u marrë me çështjet e brendshme. "Sfidë tjetër natyrisht se është arritja e marrëveshjes me Serbinë. Ekziston një farë droje në përgjithësi se shumica e energjisë së qeverisë së re do të fokusohet tek arritja e kësaj marrëveshjeje. Ndërkohë që, sipas mendimit tim, qytetarët në masë të madhe i kanë votuar këto dy parti që kanë dalë të parat në zgjedhje për t'u marrë me çështjet e brendshme. Kështu që është goxha problematike që qeveria të dijë ta orientojë energjinë dhe angazhimin. Si prioritet në politikën e jashtme po nënkuptoj edhe këtë arritjen e marrëveshjes me Serbinë. Po ashtu, është e rëndësishme të dihet se cilat do të jenë vendimet e para të qeverisë së re", ka thënë ai, duke shtuar se do të jetë e vështirë që brenda një kohe të shkurtër të zgjidhen problemet që janë grumbulluar gati që dy dekada. Mushkolaj ka folur edhe për përbërjen e re të Kuvendit të Kosovës, duke thënë se legjislatura e shtatë, bazuar në rezultatet preliminare, do të jetë më e mirë sesa e kaluara. "Do të kisha dashur që disa figura që i kemi parë vazhdimisht në Kuvend, por që nuk kanë kontribuar sa duhet dhe kanë qenë aty më shumë, se e kanë një fare mbështetje në elektorat e të partisë të mos jenë më, por t'u

jepet hapësirë disa figurave të reja të cilat përnjëmend janë profesioniste dhe mund të japin më shumë në Kuvend. Përndryshe, në vazhdimësi Kuvendi është përbërë prej figurave të konsumuara politikisht. Jam i bindur se përbërja e re e Kuvendit do të jetë më e mirë sesa legjislatura e kaluara për shkak se rezultatet preliminare po i nxjerrin në pah figurat e reja të cilave u është dhënë më shumë mbështetje sesa herëve të tjera", ka theksuar ai.

Procesi i dialogut do të jetë një nga çështjet më urgjente

Edhe menaxheri i projektit të Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) për monitorimin e Kuvendit të Kosovës dhe njohësi i proceseve zgjedhore dhe politike, Artan Murati, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se legjislatura e shtatë nuk duhet t'i ngjajë paraprakes. "Legjislatura e gjashtë ishte ndër më joefikaset në histori të Kuvendit,

andaj nuk duhet të merret si shembull se si do të duhej të funksiononte një legjislaturë. Pres që deputetët që do ta marrin mandatin për legjislaturën e shtatë të punojnë me zell, ta marrin seriozisht rolin e tyre dhe ta vlerësojnë peshën e votës që do ta marrin nga qytetarët e vendit. Kosovën e presin procese të rëndësishme andaj deputetët duhet të jenë vigjilentë dhe shumë të përgjegjshëm në punën të cilën do ta kryejnë", ka theksuar ai. Po sipas Muratit, Qeverinë e re të Kosovës e presin shumë sfida, përfshirë këtu zhvillimin ekonomik, sundimin e rendit dhe ligjit, shëndetësinë, arsimin dhe të tjera. "Republika e Kosovës gjendet në udhëkryq në aspekt të politikës së jashtme e, po ashtu, me sfida të mëdha në jetën e përditshme të qytetarëve të vendit. Numri i lartë i papunësisë, zhvillimi ekonomik, sundimi i rendit dhe i ligjit, funksionalizimi i arsimit dhe i shëndetësisë janë vetëm disa prej çështjeve urgjente që duhet të trajtohen denjësisht nga institucionet që dalin pas zgjedhjeve të 6 tetorit",

ka deklaruar Murati, duke shtuar se vazhdimi i dialogut do të jetë një prej çështjeve më urgjente të qeverisë së re. "Procesi i dialogut do të jetë një nga çështjet më urgjente me të cilat do të përballet qeveria e re. Pas aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, tanimë është e qartë se kushdo që do ta udhëheqë qeverinë do të merret me dialogun me Serbinë. Po ashtu, në raport me BE-në, qeveria e re do të ketë punë të dyfishtë pasi, përveç fillimit të punës me institucionet e sapokrijuara në BE pas zgjedhjeve të qershorit, në të njëjtën kohë duhet të punojë edhe në proceset që tanimë kanë filluar e që kërkojnë zgjidhje. Lobimi për liberalizimin e vizave për qytetarët do të jetë prioritet i qeverisë në ardhje, e bashkë me vizat qeveria do të duhej që me ngulm t'i shtyjë përpara proceset integruese të Republikës së Kosovës për në BE, duke garantuar edhe implementimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit si dhe Agjendën për Reforma Evropiane", ka thënë Murati.

Kosnetti: Qytetarët votuan për fundin e korrupsionit

PRISHTINË, 11 TETOR (ER) - Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Kosovë, Philip Kosnett, ka thënë se rezultatet e zgjedhjeve në

Kosovë kanë treguar se qytetarët kanë votuar për ta parë fundin e korrupsionit. Megjithatë, ai ka thënë se mbetet të shihet nëse partitë politike në pozitë dhe në

opozitë do të ndërmarrin një veprim përfundimtar për këtë çështje. "Rezultatet e zgjedhjeve tregojnë se njerëzit duan ta shohin fundin e korrupsionit. A

do të ndërmarrin të gjitha partitë, në pozitë dhe opozitë, një veprim përfundimtar për këtë?", ka shkruar Kosnett në llogarinë e vet në "Twitter".



Flet për "Epokën e re", Jeta Krasniqi

Kosova duhet të ndërtojë qëndrim



Menaxherja e projektit për dialogun Kosovë - Serbi në Institutin Demokratik të Kosovës (KDI), Jeta Krasniqi, ka thënë se qeverisë së re i mbetet që ta ndërtojë konsensusin e nevojshëm nacional për dialogun Kosovë - Serbi. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ajo ka deklaruar se tani pala e Kosovës duhet të ndërtojë një qëndrim të qartë dhe unik për këtë çështje. Sipas saj, përfaqësuesi special i presidentit amerikan për dialogun Kosovë - Serbi do të përpiket që t'i kthejë palët sa më parë në tryezën e diskutimit, duke investuar fuqinë e tij politike në arritjen e marrëveshjes përfundimtare

interesit shtetëror të Kosovës në tryezën e diskutimit si dhe ndërtimin e një strategjie të qartë të shtetit të Kosovës lidhur me këtë proces", është shprehur Krasniqi.

"Epoka e re": Znj. Krasniqi, Richard Grenell, përfaqësues special i presidentit të ShBA-së për dialogun Kosovë - Serbi, sapo ka vizituar Kosovën ku është takuar me gjithë përfaqësuesit politikë. Si e keni parë këtë vizitë?

Krasniqi: Vizita e z. Grenellit qartazi sjell mesazh të mbështetjes së ShBA-së rreth procesit të dialogut Kosovë - Serbi dhe angazhim të tyre të drejtpërdrejtë për arritjen e një zgjidhjeje në mes të palëve që do të kornizohen si një marrëveshje ligjërishit e obligueshme në mes palëve. Z. Grenell vjen në një kohë të pas zgjedhjeve kur qeveria e ardhshme pritet të sjellë ndryshime qoftë në qeverisjen e brendshme të vendit, por dhe

në vetë procesin e dialogut. Prandaj, besoj se mesazhet e tij kanë qenë nën drejtim të kërkesës për rikthim në tryezën e dialogut, për nevojën e arritjes së një marrëveshjeje dhe atë çfarë e kemi dëgjuar dhe më parë për një dritare të mundësisë e cila është e hapur tashmë kur shihet se vetë presidenti Trump ka kthyer vëmendjen ndaj këtij procesi.

"Epoka e re": Gjatë vizitës ai bëri me dije se pret që palët shumë shpejt t'i kthehen dialogut. Sa është e mundshme një gjë e tillë, duke pasur parasysh procesin në të cilin gjendet Kosova?

Krasniqi: Të gjitha partitë politike në Kosovë kanë shprehur përkushtimin e tyre për proces të dialogut Kosovë - Serbi. Pala kosovare në asnjë çast nuk ka shprehur hezitim për të biseduar me Serbinë, duke qëndruar të hapur pavarësisht prej sjelljeve të Serbisë. Përkundrazi, ka qenë Beogradi zyrtar i cili ka

EPOKA E RE **Muahmet KOCI**

PRISHTINË, 11 TETOR - Menaxherja e projektit për dialogun Kosovë - Serbi në Institutin Demokratik të Kosovës (KDI), Jeta Krasniqi, ka bërë me dije se emërimi i ambasadorit amerikan në Gjermani, Richard Grenell, si përfaqësues special për dialogun Kosovë - Serbi, dëshmon përkushtim e shtuar të administratës Trump për këtë proces. Ajo ka deklaruar se Grenell do të përpiket që t'i kthejë palët sa

më parë në tryezën e diskutimit, duke investuar fuqinë e tij politike në arritjen e marrëveshjes përfundimtare.

Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ajo ka thënë se tani palës së Kosovës në dialogun me Serbinë i mbetet që të ndërtojë qëndrim të qartë dhe unik. "Palës kosovare i mbetet që të ndërtojë qëndrim të qartë dhe unik dhe këtë mbështetje amerikane ta kthejë në mbrojtje të interesit të saj. Është më se e qartë që Kosova duhet të dalë shtet edhe më i fuqishëm në arenën ndërkom-

bëtare dhe më i konsoliduar në aspektin e brendshëm nga kjo marrëveshje me Serbinë. Por, për t'u arritur këto objektiva, pala kosovare duhet të jetë mirë e përgatitur, e qartë në kërkesat e saj dhe unike", ka thënë Krasniqi, duke shtuar se qeverisë së re i mbetet që ta ndërtojë konsensusin e nevojshëm nacional për këtë çështje. "Mbetet tejet e rëndësishme që Qeveria e re ta ndërtojë konsensusin e nevojshëm politik për ta çuar përpara këtë proces, ndërtimin e një qëndrimi unik për të garantuar ruajtjen e

të qartë dhe unik për dialogun

garantuar ruajtjen e interesit shtetëror të Kosovës në tryezën e diskutimit si dhe ndërtimin e një strategjie të qartë të shtetit të Kosovës lidhur me këtë proces.

"Epoka e re": Si vrojtuese e procesit të dialogut Kosovë - Serbi, çfarë ndikimi priti në këtë Grenelli në dinamikën e këtij procesi?

Krasniqi: Emërimi i ambasadorit amerikan në Gjermani, z. Grenell, drejtpërdrejt nga ana e presidentit Trump si i dërguar special për dialogun Kosovë - Serbi, dëshmon përkushtim të shtuar të kësaj administrate ndaj këtij procesi, mbi të gjitha investim të shtuar amerikan për një marrëveshje eventuale në mes të palëve. Pala e Kosovës në vazhdimësi ka kërkuar përfshirjen më të madhe amerikane në procesin e ndërmjetësuar nga BE-ja. Dhe vetë emërimi i z. Grenell e dëshmon këtë përkushtim. Z. Grenell do të përpiqet që t'i kthejë palët sa më parë në tryezën e diskutimit, duke investuar fuqinë e vet politike dhe ndikimin politik për një marrëveshje siç tashmë e kemi dëgjuar të artikulohet, marrëveshje e paqes. Palës së Kosovës i mbetet që të ndërtojë qëndrim të qartë dhe unik, dhe këtë mbështetje amerikane ta kthejë në mbrojtje të interesit të vet. Është më se e qartë që Kosova duhet të dalë shtet edhe më i fuqishëm në arenën ndërkombëtare dhe më i konsoliduar në aspektin e brendshëm nga kjo marrëveshje me Serbinë, por për t'u arritur këto objektiva, pala kosovare duhet të jetë mirë e përgatitur, e qartë në kërkesat e saj dhe unike.

"Epoka e re": Ndërkohë i kemi parë qëndrimet e z. Kurti, liderit fitues të këtyre zgjedhjeve rreth këtij procesi. A do të arrijë kryeministri i ri dhe qeveria e re ta ndryshojnë qasjen e këtij procesi?

Krasniqi: Z. Kurti e ka shprehur qartazi që dialogu, siç ka vazhduar deri më tani, nuk do të mbetet i tillë edhe në të ardhmen. LV-ja dhe vetë z. Kurti si udhëheqës i kësaj partie kanë vlerësuar se duhet të ketë së pari një dialog të brendshëm me komunitetin serb të Kosovës, duhet të ketë një vlerësim të 33 marrëveshjeve të arritura deri më tani dhe duhet të ketë një konsensus të brendshëm rreth këtij procesi ku kërkesat e Kosovës përfshijnë tema që kanë të bëjnë me kohën e okupimit, të suksesionit dhe të viteve të luftës - dëmeve

materiale e njerëzore të shkatëruara nga shteti i Serbisë. Ashtu siç kemi parë edhe në të kaluarën, edhe kjo qeveri do ta sjell qasjen e vet rreth procesit të dialogut. Gjithsesi mbetet fakti që ky proces ka tashmë tetë vjet që ka filluar, pala kosovare jo gjithmonë ka arritur ta mbrojë në tërësi interesin e Kosovës në tryezën e diskutimit. Mbetet një sfidë e madhe e cila kërkon mobilizim të gjithëmbarshtëm politik e shoqëror, për t'i riparuar dëmet e bëra, mbi të gjitha për të garantuar që diskursi i këtij procesi ndryshon nga ai që Kosova duhet të japë diçka në këmbim të së drejtës së vet për të qenë shtet i pavarur dhe sovran.

"Epoka e re": Tashmë dihet që prijës të këtij procesi do të jenë

presidenti dhe kryeministri. Duke pasur parasysh raportet e deritashme të z. Thaçi dhe të z. Kurti, sa vështirë do të jetë arritja e një konsensusi nacional për këtë çështje?

Krasniqi: E kemi parë që Kosovës i ka munguar konsensusi nacional në dy vjetët e fundit rreth kësaj çështjeje, pasi teza e korrigjimit të kufijve, e paraqitur nga presidenti Thaçi, nuk e ka gjetur mbështetjen as të qeverisë dhe as të partive politike. Kosova ka një demokraci të re, si shtet i ri që është, por në këto vite demokraci ne kemi mësuar që pa konsensus tezat e mëdha nuk mund të shtyhen përpara. Serbia nuk është në pozitën që ka qenë dikur në fillim të vitit 2000. Tani ndodhet në një pozitë shumë më të

favorshme ndërkombëtare, andaj përpjekjet e shtetit të Kosovës dhe të krerëve institucionalë duhet të shkojnë drejt përgatitjes sa më të mirë të pozitës së Kosovës dhe jo luftës së brendshme ditore.

Është e pamohueshme që fuqia politike e presidentit Thaçi në Kosovë është e madhe, por Kushtetuta e Kosovës i ka shumë të qarta obligimet. Përgjegjësit e secilit institucion dhe bashkërendimi institucional duhet të bazohen pikërisht në këto prerogative. Sfiduese mund të jetë, por kur qëllimi është shteti i Kosovës, atëherë krerët institucionalë e kanë edhe për obligim ruajtjen e shtetit të Kosovës dhe detyrimisht duhet të punojnë në këtë drejtim.

Kurti thotë se qeveria e ardhshme do t'i ketë 12 ministri

Prishtinë, 11 tetor - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka thënë se në takimet me të dërguarin presidencial amerikan për bisedimet Kosovë - Serbi është diskutuar për arritjen e një marrëveshjeje brenda disa muajsh. Por, ai tërheq vërejtjen se perspektiva e një marrëveshjeje vështirësohet kur afati kohor vihet përpara përmbytjes.

Në intervistën dhënë për "Zërin e Amerikës", Kurti ka thënë se projekti për shkëmbim territorësh ndërmjet Kosovës dhe Serbisë ka dështuar, por ideja ende nuk ka vdekur dhe se qeveria e tij do t'i japë fund asaj. "Projekti për shkëmbimin territorial midis Kosovës dhe Serbisë ka dështuar. Më duhet të pranoj se ideja nuk ka vdekur, projekti ka dështuar, pra ideja nuk ka vdekur. Me qeverinë tonë jo vetëm se projekti i dështuar vultose, mirëpo vdes edhe një ide e tillë meqenëse nuk mund të shtremi thua se jemi para një çerek shekulli dhe me lapsa mbi hartë luajmë rolin e (Franjo) Tugjmanit e Millosheviqit teksa ndajnë dhe copëtojnë Bosnjën. Mendoj se ajo kohë ka kaluar. Tash jemi në kohë të paqes dhe kemi nevojë që sa më shpejt të bëjmë hapa të qëndrueshëm drejt anëtarësimit të të gjithë Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian", është shprehur Kurti, duke shtuar se si të vijë në postin e kryeministrit do të shikojë se deri ku ka shkuar

zbatimi i marrëveshjeve të arritura në dialog me Serbinë. "Besoj se do të ketë dhe duhet të ketë dialog me Serbinë, sepse kemi shumë çështje të hapura, mirëpo statusi i Kosovës nuk është njëra prej tyre. Ne konsiderojmë se me Serbinë tashmë i kemi 33 marrëveshje në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve dhe duhet ta shohim qysh në muajin e parë në zyrë një bilanc të zbatimit të tyre dhe të ndikimit të tyre në realitetin e qytetarëve", është shprehur ai. Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, gjatë kësaj interviste ka folur edhe për zvogëlimin e numrit të ministrave. Ai ka thënë se qeveria e ardhshme do t'i ketë 12 ministri. "Punët e para tashmë i kemi nisur në bisedat që kishim me Lidhjen Demokratike të Kosovës. U pajtuam plotësisht për qeveri të zvogëluar dhe efikase dhe për shtet sa më të

fortë e të fuqishëm, që do të thotë se nga 21 ministri sa ishin, ne do t'i zvogëlojmë me synimin tonë që të jenë rreth 12 prej tyre dhe jo më shumë se kaq, ndërkohë që numri i zëvendësministrave nga mbi 80 sa ishin të mos jenë, të themi më shumë se një e treta që kishim në qeverisjen e dy vjetëve të shkuara. Po ashtu, jemi pajtuam të kemi përfaqësim të duhur gjinor, me ç'rast të jenë së paku 30 për qind gra edhe në mesin e ministrave dhe të zëvendësministrave. Lëvizja Vetëvendosje dhe Lidhja Demokratike e Kosovës nuk mund të kenë alternative të tjera përveç se njëra-tjetrën, do ta vazhdojmë kontaktin edhe me pakicat e tjera joserbe dhe do të ecim drejt, mbarë e mirë, për Qeveri të Republikës së Kosovës e cila do të jetë po ashtu e drejtë, e mbarë dhe e mirë", ka thënë Kurti.



kushtëzuar procesin e dialogut me heqjen e taksës 100 % ndaj produkteve të Serbisë, masë kjo të cilën Qeveria në dorëheqje e Kosovës e vendosi si përgjigje ndaj sjelljes aspak konstruktive të Serbisë, fushatës së saj ndërkombëtare kundër shtetit të Kosovës dhe anëtarësimit të saj në organizata ndërkombëtare siç ishte dhe në rastin e lobimit të saj kundër anëtarësimit të Kosovës në Interpol. Në këtë fazë ku ndodhet Kosova, duhet ta presim formimin e institucioneve të reja të cilat do të kenë legjitimitet qytetar për ta vazhduar procesin e dialogut Kosovë - Serbi. Në momentin e formimit të qeverisë së re dhe të konstituimit të Kuvendit është e pritshme që qeveria e re ta ndërtojë pozicionin e vet kundrejt këtij procesi. Mbetet tejet e rëndësishme që qeveria e re ta ndërtojë konsensusin e nevojshëm politik për ta çuar përpara këtë proces, ndërtimin e një qëndrimi unik për ta


ShSKUK-ja furnizohet me 26 ultrazë për spitale dhe klinika

PRISHTINË, 11 TETOR (ER) - Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar (ShSKUK) është furnizuar me 26 ultrazë për nevojat e klinikave të QKUK-së dhe spitaleve të përgjithshme. Pacientët, por edhe stafi mjekësor, më nuk do të kenë mungesë të pajisjeve të tilla për diagnostikim të mirë. Këto pajisje kanë kushtuar 338 mijë e 900

euro. Dy ultrazë do të shkojnë në Spitalin e Mitrovicës, dy në atë të Vushtrrisë, dy në Ferizaj, dy në Gjilan, dy në Prizren, dy në Gjakovë dhe dy në Spitalin e Pejës. Dy ultrazë do të dërgohen në Klinikën e Gjinekologjisë, një në Kirurgji Abdominale, tri në Klinikën e Radiologjisë, një në

Urologji, një në Emergjencë, një në Gastroenterologji me Hepatologji dhe një në Klinikën e Anetezionit dhe Mjekimit Intensiv, një në Fiziatri dhe një në Nefrologji.

ShSKUK-ja ka iniciuar procedurat për blerje edhe të pajisjeve të tjera që janë të domosdoshme për pacientët.



Këshilli Nacional i Infermierisë kërkon që infermierët të paguhen sipas shkollimit



EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 11 TETOR - Në takimin e parë të Këshillit Nacional Këshillëdhënës të Infermierisë është kërkuar që të bëhet një diferencim sa i përket pagesës së infermierëve sipas profilit të tyre të shkollimit. Sipas njoftimit për media, pagesa e infermierëve sipas profilit të shkollimit ishte vetëm një nga kërkesat e para të bëra në takimin e parë të Këshillit Nacional Këshillëdhënës të Infermierisë të themeluar nga Oda e Infermierëve të Kosovës.

Kryetari i Odës së Infermierëve të Kosovës, Naser Rrustemaj, ka thënë se të gjitha propozimet që do të jepen nga ky këshill do të dërgohen në organet e OIK-ut që komitetit infermieror t'i dilet në ndihmë.

Natyrë Karahoda, kryesuese e Këshillit Nacional Këshillëdhënës të Infermierisë, ka thënë se shpreson se do të ndihmojë në kapacitetet e saj. "Si çdoherë do ta keni mbështetjen time për fuqizimin e infermierisë në Kosovë për arsye se thellë mendoj se është një fushë e cila është shumë specifike dhe e rëndësishme", ka thënë ajo.

Karahoda ka thënë se shpreh kënaqësinë që ka arritur të shohë një evolucion ku në Kosovë vlerësohet puna dhe rëndësia e infermierisë për dallim prej viteve pas luftës.

Hysni Bajrami, zëvendëskryetar i këtij këshilli, ka thënë se ky forum ka mbledhur eminencën e infermierisë dhe është krijuar një mekanizëm politikbërës. "Ajo që ne mendojmë se shkon në favor të interesit profesional, diskutohet këtu në këshill e pastaj të shkojnë politikat tek organet e Odës", ka thënë ai. Bajrami ka thënë se jorastësisht në këtë këshill janë edhe

përfaqësuesit infermierorë të Shqipërisë. "Kemi shumë retorikë se po bashkohemi, por janë disa çështje praktike që ballafaqohemi. Ka mbaruar qytetari i Kosovës licencën në Shqipëri, Kosova nuk e pranon. Ka dhënë provim shtetëror në Shqipëri, Kosova nuk e pranon. Gjërat më elementare që mund të rregullohen", ka thënë Bajrami.


Blerina Duka, kryetare e Urdhrit Infermieror në Shqipëri, ka thënë se beson se kjo tryezë është një ide jashtëzakonisht e mirë që do të shërbejë për Kosovën dhe Shqipërinë. "Kjo na mundëson të punojmë bashkë

në të mirë të komunitetit", ka theksuar ajo.

Muharrem Arifi, anëtar i këshillit, ka thënë se duhet menjëherë të fillohet me propozime konkrete. Ai ka thënë se një ndër to është të kryhet pagesa sipas kualifikimeve, për infermierët e diplomuar në fakultet apo ata me shkollë të mesme.

Ky këshill, që është formuar para një muaji, do t'i propozojë Odës masa për mbrojtjen, prezantimin dhe avancimin e intereseve profesionale të anëtarëve të OIK, si dhe promovimin e standardeve të larta të Kodit të Etikës dhe Deontologjisë.

Fillon organizimi në 11 shtete për "Ditët e kulturës shqiptare" në diasporë



PRISHTINË, 11 TETOR (ER) - Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike (MDIS) ka filluar organizimin për "Ditët e kulturës shqiptare" në diasporë. Ky është një prej aktiviteteve më të rëndësishme të MDIS-it, ku përmes programeve dhe organizimeve kulturore artistike dhe letrare

promovohet dhe kultivohet gjuha dhe tradita shqiptare në botë.

"Ditët e kulturës shqiptare" në diasporë kanë nisur me një manifestim kulturor të mbajtur në Kroaci, saktësisht në Prefekturën e Pozhegës dhe Brodit.

Ndërsa aktivitete të ngjashme

do të ketë pothuajse në tërë muajin tetor dhe nëntor. MDIS organizon "Ditët e kulturës shqiptare" në 11 shtete të ndryshme, përfshirë këtu Slloveninë, Gjermaninë, Austriinë, Italinë, Suedinë, Kroacinë, Turqinë, Zvicrën, Anglinë, ShBA-në dhe Kanadanë.

41 persona dyshohen se kanë kryer vepra penale gjatë procesit zgjedhor

PRISHTINË, 11 TETOR (ER) - Prokurori i Shtetit ka njoftuar opinionin publik se gjatë procesit zgjedhor për Kuvendin e Kosovës, që është mbajtur më 6 tetor, prokurorët kanë qenë të angazhuar për parandalimin e cenimit të drejtës së votës dhe ndjekjen penale ndaj kryesve të veprave penale kundër të drejtës

së votimit. Ky institucion ka bërë me dije se janë paraqitur 35 informata për 41 persona të cilët dyshohen se kanë kryer vepra penale në lidhje me procesin zgjedhor. "Rastet e paraqitura te Prokurori i Shtetit dhe ato të filluara me iniciativën e tij, në bazë të informatave të marra nga mediet dhe

shoqëria civile, janë trajtuar me përparësi nga prokurorët. Deri në ditën e sotme Prokurorit të Shtetit i janë paraqitur tridhjetepesë (35) informata për dyzetënjë (41) persona nën dyshimin se kanë kryer veprat penale që lidhen me procesin zgjedhor, prej të cilëve shtatë (7) komisionarë dhe tridhjetekatër (34) qytetarë.

Për më tej, nga numri i përgjithshëm i këtyre 41 personave, njëzetepesë (25) prej tyre janë ndaluar (për 48 orë), për dy (2) prej tyre gjykata ka shqiptuar masën e paraburgimit, ndërsa ndaj një (1) të dyshuari gjykata ka shqiptuar masën e arrestit shtëpiak", është thënë në njoftimin e Prokurorit të Shtetit.



Ministria e Jashtme kërkon që Peter Handkesit t'i merret Nobeli

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 11 TETOR - Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Kosovës ka shprehur shqetësimin e thellë për ndarjen e Çmimit Nobel shkrimtarit austriak Peter Handke, përkrahësit të Slobodan Millosheviqit, të akuzuarit për gjenocid dhe krime kundër njerëzimit në Kosovë dhe njësi të tjera të ish-Jugosllavisë. Përmes një reagimi për medie, MPJ-ja ka kërkuar nga Akademia Suedeze ta rishqyrtojë dhënien e Çmimit Nobel për Letërsi. "Akademia Mbretërore Suedeze e Shkencave, institucion me renome botërore, ndan çmimin prestigjioz Nobel për fusha të ndryshme bazuar në vlerësimin profesional, moral dhe etik. Kësaj radhe gjykojmë që çmimi i është dhënë njeriut të gabuar - mohuesit të gjenocidit. Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Kosovës kërkon nga Akademia Suedeze ta rishqyrtojë dhënien e Çmimit Nobel për Letërsi një njeriu që mund të jetë genial si shkrimtar, por që në jetën publike është treguar mohues i të drejtave të njeriut duke dalë publikisht në anën e dikujt që më pas vdiq në Hagë si i akuzuar nga Gjykata Ndërkombëtare për Krime Luftë", është thënë në reagimin e MPJ-së.

Ministria e Punëve të Jashtme e Kosovës, po ashtu, u ka bërë thirrje edhe institucioneve relevante botërore, akademike shkencore dhe organizatave që merren me mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ta ngrehin



zërin e tyre dhe ta shprehin kundërshtimin me vendimin e Komitetit të Nobelit. "Emri i Petar Handkes në Kosovë është sinonim i së keqes, mbështetës i një pushteti shovinist. Çmimet që i ndahen një njeriu të këtillë zhvlerësojnë përpjekjet e shoqërive demokratike për një botë paqedashëse. Nuk e nderojnë asnjë institucion akademik, as Akademinë Suedeze. Në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Kapitulli II, Të Drejtat dhe Liritë

Themelore, Neni 21, Pika 3 thuhet: Çdokush e ka për detyrë t'i respektojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve. Prandaj, bazuar në Kushtetutën tonë, populli i Kosovës të paktën nuk mund të ketë respekt për veprën e z. Handke dhe ndihet i fyer që çmimi iu nda njeriut që dikur ia uronte ferrin", është thënë në reagimin e MPJ-së.

Edhe Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) u është bashkuar zërave vendorë dhe atyre ndërkombëtarë duke dënuar ashpër ndarjen

e çmimit Nobel për letërsi për vitin 2019 për shkrimtarin austriak Peter Handke. "Handke, i njohur si përkrahës i regjimit të Slobodan Millosheviqit, haptazi mohoi masakrat që ndodhën në Ballkan, duke u deklaruar edhe kundër bombardimeve të NATO-s në Kosovë. Ai publikisht sugjeroi se myslimanët e Sarajevës masakruan vetveten si dhe mori pjesë në varrimin e kriminelit të luftës, Millosheviq. RrGK-ja sjell ndër mend se gjatë regjimit të Millosheviqit në Kosovë janë

dhunuar seksualisht 20 mijë persona si dhe sot 20 vjet pas përfundimit të luftës, mbi 1600 persona janë akoma të zhdukur. Duke kujtuar aktivizmin dhe përpjekjet që RrGK-ja ka bërë për më shumë se dy dekada në emër të kërimit të barazisë, lirisë dhe vlerave demokratike, RrGK konsideron se ndarja e këtij çmimi për Handke është fyerje e madhe për secilën viktimë të shovinizmit serb", është thënë në reagimin e RrGK-së.

LDK-ja ndal bisedimet me Vetëvendosjen, pret certifikimin e rezultatit zgjedhor

PRISHTINË, 11 TETOR - Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka marrë vendim që negociatat për formimin e koalicionit qeverisës me Lëvizjen Vetëvendosje t'i vazhdojë pasi të shpallet rezultati përfundimtar i zgjedhjeve parlamentare të 6 tetorit. Ndonëse më 10 tetor LDK-ja dhe Vetëvendosje ishin pajtuar në parim, që t'i nisnin negociatat për koalicion, të premtën kryesia e Lidhjes Demokratike e Kosovës ka vendosur që negociatat të vazhdojnë

pas përfundimit të numërimit të të gjitha votave, duke përfshirë ato nga mërgata, votat me kusht dhe të personave me nevoja të veçanta.

Zëdhënësi i LDK-së, Besian Mustafa, u tha mediave se pas përfundimit të numërimit të votave dhe certifikimit të rezultatit do t'i vazhdojnë bisedimet me Vetëvendosjen. "Zhvillimi i negociatave do të fillojë pas certifikimit të rezultateve nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Në momentin që certifikohen rezultatet do t'i fillojmë bisedimet me Vetëvendosjen", ka thënë Mustafa.

Nga rezultatet preliminare, të publikuara deri më tani nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Lëvizja Vetëvendosje ka fituar 25.49 për qind të votave, pasuar nga Lidhja Demokratike e Kosovës me 24.82 për qind të votave. Këto rezultate nuk përfshijnë votat me kusht, votat me postë dhe votat e personave me nevoja të veçanta.



Çmimet e konsumit pësojnë rënie të lehtë në shtator

EPOKA E RE**A. MAVRAJ**

PRISHTINË, 11 TETOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar "Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit" (IHÇK) për muajin shtator të vitit 2019, viti bazë 2015=100. Inflacioni mujor i matur nga indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit ishte (-0.1 për qind) në muajin shtator 2019. Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit pësoi rënie në një mesatare prej (-0.1 përqindësh) në muajin shtator 2019, krahasuar me muajin gusht 2019. Kjo kryesisht është

shpjeguar me rënien e çmimeve të konsumit të nëngrupet e COICOP-it: mish (-0.7 për qind); qumësht, djathë dhe vezë (-0.9 për qind); pemë (-2.3 për qind); shërbime për transport (-3.6 për qind) - (rënie e çmimeve të biletave të transportit ajror); pushime të organizuara (-6.8 për qind), me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej (-0.3 përqindësh) në IHÇK. "Rënia u neutralizua kryesisht nga ngritja e çmimeve të konsumit të nëngrupet e COICOP-it: perime (0.6 për qind); kafe, çaj dhe kakao (1.4 për qind); veshje (0.9 për qind); energji elektrike, gaz dhe lëndë djegëse të tjera (1.2

për qind) - (ngritje e çmimit të drunjve të zjarrit), qelqurinat, takëmet dhe mjetet e kuzhinës (1.4 për qind), me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 0.2 përqindësh në IHÇK", është thënë në njoftimin e ASK-së. Ndërkaq shkalla vjetore e inflacionit, e matur në muajin shtator 2019, me muajin shtator 2018 ishte 2.4 për qind. Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit në këtë periudhë të nëngrupet e COICOP-it: bukë dhe drithëra (12.5 për qind); mish (3.2 për qind); qumësht, djathë dhe vezë (1.5 për qind); vajra dhe yndyra (3 për qind); pemë (1.9 për qind); sheqer, reçel,

mjaltë, çokollatë dhe ëmbëlsira (2.4 për qind); kafe, çaj dhe kakao (11.3 për qind); pije alkoolike (2 për qind); duhan (2.5 për qind); mirëmbajtje dhe rregullim i vendbanimit (1.8 për qind); energji elektrike, gaz dhe lëndë të tjera djegëse (0.8 për qind)-(ngritje e çmimit të drunjve të zjarrit); mobilie dhe orendi, qilima dhe mbulesa dyshemeje të tjera (1.3 për qind); pajisje shtëpiake (2.5 për qind); qelqurinat, takëmet dhe mjetet e kuzhinës (3.8 për qind); mallra dhe shërbime për mirëmbajtjen e zakonshme të ekonomisë shtëpiake (4.1 për qind); shërbime ambulatore (1.7 për qind); blerje e automjeteve

(1.5 për qind); pushime të organizuara (5.9 për qind); shërbime për strehim (4.6 për qind); gjëra personale (3.2 për qind), me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 2.6 përqindësh në IHÇK. "Ngritja u neutralizua kryesisht nga rënia e çmimeve të konsumit të nëngrupet e COICOP-it: perime (-3.2 për qind); shërbime për transport (-2.9 për qind)-(rënie e çmimeve të biletave të transportit ajror); pajisje audio-vizuale, fotografike për përpunimin e informatave (-3.3 për qind), me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej (-0.2 përqindësh) në IHÇK", është theksuar në njoftimin e ASK-së.



Në Shtërpçë u protestua kundër ndërtimit të hidrocentralit

SHTËRPCË, 11 TETOR - Banorët e fshatit Biti të Shtërpçës kanë protestuar edhe të premtën kundër ndërtimit të hidrocentralit në lumin Lepenc. Në përkrahje të tyre ka dalë edhe Federata e Bjeshkatarëve "Alpinistët e Kosovës" e që bashkë me të është parë edhe alpinistja Uta Ibrahim. Në këtë protestë është bërë sërish thirrje që të mos ndërtohet hidrocentrali në lumin Lepenc, për të cilin banorët thonë se do t'ua vështirësonte jetën. Disa nga pankartat që protestuesit i kanë mbajtur në duar kanë qenë "Uji është jetë", "Mos na e varrosni Lepencin" dhe pankarta të tjera. Nga ajo që kishte ndodhur disa ditë më herët, kjo protestë ka

përfunduar e qetë, pa ndërhyrje të policisë dhe banorët tashmë kanë nisur të shpërndahen. Ditë më parë, në protestën e banorëve të Bitisë së Poshtme të Shtërpçës, kishte ndërhyrje të policisë, e cila ishte përdorur edhe gaz lotsjellës. Protestuesit ishin përballur me rezistencë të forcave të policisë derisa ishin duke kundërshtuar punimet që po vazhdojnë për ndërtimin e hidrocentralit. Protesta kaloi me përleshje ndërmjet banorëve dhe policisë, ku mes të lënduarve pati edhe fëmijë. Banorët e këtij fshati të Shtërpçës i kanë shpeshuar protestat gjatë muajve të fundit, kur rifilluan punimet që kanë nisur tash e sa kohë për ndërtimin e një hidrocentrali.



Banka Botërore nuk parasheh rritje ekonomike që ul papunësinë

PRISHTINË, 11 TETOR - Kosova ka vite që shënon rritje ekonomike, por shkalla e rritjes ende mbetet e pamjaftueshme për ta zbutur papunësinë dhe rimëkëmbur ekonominë. Perspektiva e rritjes ekonomike në Kosovë parashihet të jetë pozitive, me rritje mesatare prej 4.2 përqindësh. Krahasuar me vendet e rajonit, të cilat, sipas Bankës Botërore, po përjetojnë ngadalësim, Kosova ka rritje më të lartë.

Bazuar në raportin e fundit të titulluar "Rregullat ekonomike për Ballkanin Perëndimor", ku përfshihet edhe Republika e Kosovës, thuhet se niveli i rritjes ekonomike gjatë këtij viti është 4 për qind.

Parashikimet e Bankës Botërore për rritjen ekonomike për vitin 2020-2021 janë 4.2, respektivisht 4.1 për qind. Por, raporti konstaton "se ekzistojnë rreziqe të padëshirueshme që lidhen me dinamikën e politikës së brendshme dhe rajonale, vonesa të mundshme në planet e investimeve për shkak të zgjedhjeve, kostos më të lartë sesa është parashikuar të Ligjit të ri për pagat në sektorin publik dhe stabilitetit të çmimeve ndërkombëtare të metaleve".

Edhe Fondi Monetar

Ndërkombëtar më herët ka parashikuar se rritja ekonomike për vitet 2020 deri në vitin 2024 do të jetë më shumë se 4 për qind.

Ekspertë të çështjeve ekonomike vlerësojnë se, pavarësisht rritjes ekonomike, kjo normë nuk adreson problemet me të cilat përballet Kosova.

Drejtori i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, në një bisedë për "Radion Evropa e Lirë" thotë se norma e rritjes ekonomike nuk do të arrijë në 4.5 për qind. "Këto vlerësime janë të bazuara kryesisht në projektet që janë të ndikuara nga investimet publike dhe në të njëjtën kohë ndërlidhen edhe me rritjen e konsumit që lidhen me remitencat apo nga faktorë të tjerë të caktuar, siç është rritja e pagave që mund të ketë ndikim afatshkurtër, por jo ndikim afatgjatë", ka thënë Rukiqi.

Pasiviteti në tregun e punës në rajon ka pësuar rritje gjatë vitit 2019, thuhet në raport, kurse në Kosovë dhe në Bosnje e Hercegovinë, sipas raportit, numri i njerëzve që kanë lënë punën është më i lartë se i atyre që kanë gjetur punë.

Shkalla e papunësisë në Kosovë, sipas të dhënave zyrtare, është



25.3 për qind.

Edhe eksperti tjetër për çështje ekonomike, Ismail Kastrati, në një prononcim për "Radion Evropa e Lirë" thotë se norma e parashikuar e rritjes ekonomike nuk është e mjaftueshme për zvogëlimin e shkallës së papunësisë në Kosovë. "Për t'u ulur

shkalla e papunësisë, rritja ekonomike duhet të jetë mbi 7 për qind. Ndërsa 21 për qind e investimeve duhet të jenë të ndara nga Bruto Produkti Vendor", thekson Kastrati.

Ndërkaq Berat Rukiqi konsideron se parashikimet e institucioneve financiare ndërkombëtare për

rritje ekonomike nuk arrijnë ta ulin shkallën e papunësisë në vend. "Kosova, edhe pse ka një ulje të papunësisë edhe te të rinjtë, mbetet një ndër vendet me normat më të larta në rajon. Kështu që, me këtë nivel të rritjes ekonomike dhe duke pasur parasysh numrin e madh të të rinjve që dalin në treg të punës për çdo vit është e pamundshme që të adresohet me këtë rritje zgjidhja e këtij problemi që është problem kryesor ekonomik në vend", ka vlerësuar Rukiqi.

Raporti i Bankës Botërore, gjithashtu, bën thirrje për një përmirësim të shpejtë të shpenzimeve publike dhe konkurrueshmërisë së ekonomive. Aty kërkohet edhe forcimi i kontrollit të shpenzimeve publike për paga, reduktimi i shpenzimeve tatimore dhe përmirësimi i programeve të përkrahjes sociale.

Nga parashikimet e Bankës Botërore dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar, subjektet politike që garuan në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 6 tetorit kanë premtuar rritje të normës vjetore ekonomike në Republikën e Kosovës, nga 6 deri 9 për qind, për katër vjetet e ardhshëm.

KEDS-i hapi dyert për Ditën Ndërkombëtare të Vajzave



PRISHTINË, 11 TETOR (ER) - Dyert e KEDS-it janë hapur të premtën për një grup vajzash me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Vajzave. Tiara, Bora, Nina dhe Tuana kanë parë së afërmi KEDS-in, vendin ku punojnë prindërit e tyre. Ato janë shpre-

hur të entuziazmuara nga puna që bëhet këtu për ndriçimin e Kosovës. "Do të doja të punoja këtu për t'i ndriçuar shtëpitë e njerëzve. Më pëlqen puna me kompjuter dhe t'u përgjigjem njerëzve përmes telefonit", thotë Bora Puka, nxënëse e

klasës së dytë.

Edhe vajzat e tjera janë shprehur se do të donin të ishin pjesë e ndriçimit të vendit. Por, Tuana Avidiu ka edhe një arsye shtesë. "Kisha punuar në vend të babit, pasi ai po ka shumë punë. Do t'ia merrja një pjesë të punës në

mënyrë që t'i ndihmoja", thotë Tuana, nxënëse e klasës së IV.

Vajzat kanë parë së afërmi punën që bëhet në Qendrën Dispecerike të KEDS-it, ku janë të instaluar edhe sistemet moderne të SCADA-s dhe Kosovanet-it.

Vizita ishte pjesë e programit për avancimin e pozitës së vajzave në shoqëri përmes Asociacionit të Grave në Sektorin e Energjisë në Kosovë. KEDS-i i është përgjigjur pozitivisht aktivitetit të këtij asociacioni në mënyrë që ta japë kontributin e vet.

Rreth 30 gra nga Kamenica bëjnë ekzaminimin në mamografin mobil

KAMENICË, 11 TETOR (ER) - Me rastin e shënimit të muajit tetor, i cili njihet si muaj i ndërgjegjësimit në luftën kundër kancerit të gjirit, drejtoresha e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Suna Zajmi-Krasniqi, ka marrë iniciativë që disa grave nga Komuna e Kamenicës t'u bëhet ekzaminimi në mamografin mobil. Kjo iniciativë e saj është bërë e mundshme falë bashkëpunimit me drejtorin e Shëndetësisë në

Prishtinë, Bujar Gashi, drejtoreshën e QKMF-së në kryeqytet, Sadete Hadri dhe radiologun Avdi Sopi. Sipas drejtoreshës Zajmi-Krasniqi, është jashtëzakonisht e rëndësishme që grave nga Komuna e Kamenicës t'u mundësohet ekzaminimi. "Këtë vit kemi mundësuar ekzaminimin e rreth 30 grave nga Kamenica dhe shpresoj se në vitet e tjera ta rrisim numrin e tyre. Jam jashtëzakonisht e kënaqur që në bashkëpunim

me Drejtorinë e Shëndetësisë në Prishtinë bëmë të mundur që kjo iniciativë të jetësohet", ka thënë ajo.

Ndërsa kryetari i Kamenicës, Qëndron Kastrati, i ka inkurajuar të gjitha gratë të bëjnë vizita mjekësore për parandalimin e kësaj sëmundjeje. "Ju gra, pavarësisht se kush jeni e nga vini, kontrollohuni dhe parandaloheni këtë sëmundje e cila më të lehtë e ka parandalimin sesa trajtimin", ka thënë Kastrati.



Ura e Lumbardhit do të mirëmbahet nga Komuna e Deçanit



DEÇAN, 11 TETOR (ER) - Kontingjenti italian i Komandës Rajonale Perëndim të KFOR-it ia ka dorëzuar kompetencat Komunës së Deçanit për mbikëqyrjen e urës e cila mundëson kalimin e Lumbardhit.

Komuna e Deçanit ka bërë me dije se kjo urë nga viti 2015 është mirëmbajtur nga KFOR-i italian. "E ndërtuar në vitin 2015, ura, e cila u mundëson kalimin e lumit Lumbardh për tek uji i thartë qytetarëve të Komunës së Deçanit, sot i kalon në kompetencë Komunës së Deçanit mbase deri më tani është mirëmbajtur nga KFOR-i italian. Të pranishëm në këtë solemnitet ishin i pari i komunës, Bashkim Ramosaj me bashkëpunëtorë, ambasadori italian në Kosovë, shkëlqesia e tij Piero Cristoforo Sardi dhe komandanti i misionit në Kosovë, gjenerali i divizionit, Lorenzo D'Addario, përfaqësues të klerit fetar, ushtarakë, asamblistë dhe qytetarë të shumtë", ka Komuna e Deçanit.

Komuna e Drenasit rrënon një objekt pa leje

DRENAS, 11 TETOR (ER) - Komuna e Drenasit ka njoftuar se ka rrënuar një objekt pa leje i cili ishte ndër-tuar në tokë bujqësore. "Komuna mbetet e përkushtuar që t'i mbrojë tokat bujqësore dhe se asnjë ndërtim nuk mund të bëhet pa leje përkatëse dhe që nuk është në pajtim me ligjin. Në vazhden e këtij angazhimi, Inspektorati i Komunës së Drenasit ka realizuar një aksion për rrënimin e një objekti të ndërtuar në tokë komasative (bujqësore). Në bashkëpunim me Stacionin Policor të Drenasit, inspektorati ka ndërmarrë aksionin duke rrënuar objektin e



ndërtuar pa leje, konkretisht objekti që ndodhej në parcelën

nr. P-70314067-00036-0, zonën kadastrale Sankoc, në afërsi të

rrugës magjistrale 'Autostrada M9', Komoran", ka njoftuar Komuna e Drenasit.

Sipas këtij njoftimi, inspektorët më 9 gusht palës ndërtuese ia kishin ndërprerë punimet për ndërtimin e objektit, duke i vënë shenjën zyrtare. "Ndërsa, më datën 14. 08. 2019 të njëjtit i është lëshuar aktvendim për ndërprerjen e punimeve në tokën komasative. Më datën 18. 08. 2019 pala nuk ka respektuar aktvendimin për ndërprerjen e punimeve, duke e larguar shenjën dhe vazhduar ndërtimin. Kurse, më datën 19. 09. 2019, për herën e tretë, palës i është riven-

dosur shiriti dhe i është lëshuar aktvendimi për rrënim. Përkundër këtij aktvendimi, pala ka vazhduar ndërtimin, duke mos përfillur asnjë urdhër të inspektoratit. Në këtë formë, meqë pala ka vepruar kundërligjshëm, më datë 01. 10. 2019 palës i është lëshuar urdhri për ekzekutimin e rrënimin të objektit, ku është njoftuar se sot, në orën 09:00, do t'i rrënohet objekti", është thënë në këtë njoftim.

Kjo komunë ka ftuar të gjithë personat fizikë dhe juridikë të mos ndërmarrin asnjë veprim për ndërtime pa leje, sidomos në prona komasative.

Më 15 tetor në Prishtinë fillon procesi i eliminimit të brejtësve

PRISHTINË, 11 TETOR (ER) - Komuna e Prishtinës ka njoftuar se më 15 tetor do të fillojë procesi i deratizimit vjeshtor (eliminimit të brejtësve) i rrjetit të kanalizimit, bodrumeve dhe garazheve publike nëpër lagjet e kryeqytetit. Kjo

komunë ka theksuar se ky proces ka për qëllim ruajtjen e shëndetit publik përmes zvogëlimin dhe mbajtjes nën kontroll të numrit të brejtësve që qarkullojnë nëpër rrjetin e kanalizimit e që mund të paraqesin kërcënim për shën-

detin publik të qytetarëve. "Bashkëpunimi i qytetarëve në këtë aktivitet është shumë i rëndësishëm. Prandaj, lusim qytetarët të na përkrahin në mënyrë që ky aktivitet të realizohet me sukses. Kërkohet nga

qytetarët që t'i hapin dyert e podrumeve dhe garazheve në mënyrë që të sigurohet qasje e lehtë në këto hapësira, derisa monitorimi i këtij procesi do të jetë i vazhdueshëm", ka njoftuar Komuna e Prishtinës.



'Shengeni serbo-centrist', izolim për Kosovën, hapje portash për Rusinë



Prof. Lisen BASHKURTI

Këto ditë u bë shumë zhurmë rreth "Shengenit ballkanik" trepalësh, Serbi, Maqedoni e Veriut dhe Shqipëri që u lansua në Novi Sad. Ishte, pa pikë dyshimi, shumë zhurmë për asgjë. Nuk u firmos asnjë marrëveshje, asnjë instrument detyrues por, thjesht, u bë një deklaratë propagandistike parimesh të përziera dhe të përsëritura nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit dhe nga Marrëveshja Shengen e Bashkimit Evropian. Natyrisht, kjo nuk do thotë se ishte zhurmë pa dëm dhe pa rrezikshmëri.

1. Arnë e re në thes të shqyer

"Shengeni ballkanik" trepalësh ose "Shengeni serbo-centrist" është një ide e vjetër me petka të reja, është një doktrinë serbo-ruse me terma euro-perëndimore, është një arnë e re në një thes të shqyer, është një mirëkuptim propagandistik mbi një realitet kontradiktor.

Është ide e vjetër sepse prej më shumë se një shekulli Serbia ka tentuar në kohë, terma dhe mënyra të ndryshme të bëhet qendër e Ballkanit dhe ta dominojë atë. Fakti që këtë herë u takuan në Novi Sad nuk e zbeh aspak që Beogradi është në qendër. Doktrina e Garashaninit në vitet '40 të shekullit 19 synonte krijimin e një Serbie të Madhe, "Nacertanie", si qendër ballkanike.

Gjatë "Krizës Lindore" 1877-1878 sërish Serbia tentoi të përfitonte nga kriza ruso-osmane që të përfitonte troje e popullsi të huaja, duke synuar të bëhej qendra politike midis auto-hungarezëve, rusëve dhe osmanëve. Mbas Luftës së Parë Botërore, kur ambicet e Serbisë u përplasën në periudhën post-osmane me Vjenën dhe Italinë, Beogradi inicioi Mbretërinë Serbo-Kroate-Slovene, duke u bërë qendër e

kësaj mbretërie trepalëshe. Në periudhën midis dy luftërave botërore, Serbia centraliste u përball me rivalitetin kroato-sloven federalist. Në vitin 1929, mbreti serb, Aleksandri I, e quajti krijesën serbe "Jugosllavi", duke u përpjekur ta gjejë kompromisin me kroato-slovenët, por me qendër Beogradin.

Në këtë periudhë, midis dy luftërave botërore u ndërmorën tri konferenca ballkanike, me synimin "Ballkani, ballkanasve" si kundërvënje e fuqive evropiane por që, në fakt, ishte tendencë për dominime nacionalizmash ballkanikë, një prej më agresivëve ishte nacionalizmi serb. Tri konferencat në fjalë dështuan nga rivalitetet e brendshme ballkanike dhe problemet e pakicave etnike.

Mbas Luftës së Dytë Botërore, për shkak të influencës më të madhe në internacionalen komuniste, Bullgaria e Dimitrovit tentoi ta krijonte "Federatën Ballkanike", ide kjo që ndeshi në kundërshtim të fortë nga Beogradi. Ishte Josif Broz Tito, themeluesi i Jugosllavisë së AVNOJ-it të mbas Luftës së Dytë Botërore, që tentoi ta zgjeronte Federatën Jugosllave me përfshirjen e Shqipërisë në të. Për arsye ideologjike dhe strategjike Stalini e ndaloi një iniciativë të tillë, duke shpëtuar Shqipërinë nga gëlltitja jugosllave.

Mbas rënies së Murit të Berlinit dhe transformimeve politike dhe gjeopolitike në Evropën Lindore dhe BRSS, Jugosllavia u përfshi në krizë komplekse, në qendër të së cilës ishte ambicia e Beogradit për të vënë nën kontroll gjithë ish-Jugosllavinë e Titos. Millosheviqi i vuri republikat e ish-Jugosllavisë përballë alternativës kërcënuese: ose ta pranonin kontrollin centralist të Beogradit, ose të gjithë serbët, kudo që ndodheshin, do të bashkoheshin në një shtet të vetëm, në Serbinë e Madhe. Dihet se çfarë pasojash prodhoi politika e Millosheviqit. Mbas rënies së Millosheviqit, diktatura serbe ka rënë, por doktrina e "Serbisë së Madhe" vijon të mbetet e aktive, por e veshur me petka diplomatike dhe e kamufluuar pas termave të reja, kryesisht evropiane. Thelbi i politikës së jashtme të Serbisë ka ndryshuar shumë

pak. Ajo vazhdon të jetë nacionalisht ambicioze, duke tentuar t'i rikthejë pozitat e humbura nga koha e Millosheviqit. Këto ambicie lexohen qartë në qasjen serbe ndaj Kosovës, Bosnje-Hercegovinës, Kroacisë dhe pakicave serbe kudo që janë. Në rrafshin ballkanik, ambicia serbe vijon të mbetet për t'u rikthyer në qendër rajonale me gjithë kuptimin e kësaj fjale. Për këtë Beogradi përdor gjeostrategjinë bivektoriale euro-aziatike. "Minishengeni serbo-centrist" është pjesë e kësaj taktike të Beogradit, në të cilën u bënë pjesë edhe Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria.

2. Izolim i Kosovës me 'bekimin' e Tiranës

Takimi i Novi Sadit është paraparë që ta lërë jashtë Kosovën. Ky takim nuk mund të bëhej me Kosovën sa kohë qeveria e kaluar kishte Haradinajn kryeministër, që vuri taksën 100 për qind për importeve serbe. Por, ky takim nuk mund të bëhej me Kosovën, as me qeverinë e re, pa e ditur se kush do t'i fitonte zgjedhjet dhe do të bëhej kryeministër pas zgjedhjeve. Takimi i Novi Sadit, me qëllim që ta linte jashtë Kosovën, mund të bëhej taktikisht në periudhën vakum midis qeverisë në ikje Haradinaj dhe qeverisë në ardhje Kurti.

Nxitimi për ta bërë takimin e Novi Sadit në një kohë tranzicioni midis dy qeverive në Kosovë nuk lexohet si rastësi. I dëshpëruar me Haradinajn dhe i pasigurt me Kurtin, Vuçiqi, dhe kjo është krejt e qartë, luajti me datën e takimit të Novi Sadit për ta izoluar Kosovën. Maqedonia e Veriut bëri oportunisten, duke u pajtuar me të. Nuk është e qartë nëse Tirana zyrtare ra paditurisht në grackën e Vuçiqit apo u pajtua me vullnetin e saj. Mungesa e transparencës së Qeverisë Shqiptare nuk na ndihmon aspak për këtë. Por, sido që të jetë, as Beogradi, as Tirana, as Shkupi dhe as të tria së bashku nuk mund të flasin dhe veprojnë në emër të Kosovës dhe popullit të saj. Koha kur Beogradi, satelitët dhe serbofilët ballkanikë flisnin e vepronin në emër të Kosovës dhe popullit të saj ka mbaruar njëherë e përgjithmonë.

3. Hapje portash për Rusinë me 'bekim' të Beogradit

Nuk mund të krijohet kurrfarë Federate Jugosllave më në Ballkan, as me doktrinat e vjetra dhe as me termat e reja, as me gjuhë diplomatike të MSA dhe as me modele Shengeni evropian. MSA-në e kanë firmosur dhe ratifikuar të tri këto vende. Gjithashtu, treshja Shqipëri, Serbi dhe Maqedoni e Veriut janë edhe pjesë e Shengenit. Duke qenë pjesë e MSA-së dhe e Shengenit, Shqipëria, Serbia dhe Maqedonia e Veriut nuk kanë as çfarë shtojnë dhe as çfarë heqin mbi termat e tyre. MSA dhe Shengeni janë instrumente normative evropiane që rregullojnë katër lëvizjet e lira: të mallrave, shërbimeve, kapitaleve dhe njerëzve. Nëse këto akte normative evropiane nuk zbatohen plotësisht në Ballkan, kjo ka të bëjë me kulturën anti-juridike dhe anti-evropiane të lidhshmeve dhe administratave ballkanike, të cilat firmosin pa hezitim aktet juridike evropiane, por i shkelin ose i gjymtojnë në marrëdhëniet e fqinjësisë dhe të bashkëpunimit rajonal. Prapa mendimi i "Shengenit ballkanik serbo-centrist" është i dëmshëm dhe i rrezikshëm për Kosovën, për Ballkanin dhe mbarë BE-në. Është i dëmshëm dhe i rrezikshëm për Kosovën sepse shton presionin e shteteve ballkanike mbi të, duke përfshirë mjerisht edhe Shqipërinë, për ta rishikuar heqjen e taksës mbi importet serbe, pa kurrfarë kushtëzimi në mbrojtje të Kosovës dhe plotësisht në favor të Serbisë. Taksa mbi importet serbe në Kosovë ishte reagim vetëmbrojtës i Kosovës përballë politikave agresive armiqësore të Serbisë. Serbia ka bllokuar dialogun me shkeljen e marrëveshjes së Brukselit të vitit 2013, ka penguar integrimin e Kosovës në organizatat e UNESCO-s dhe INTERPOL-it dhe ka sponsorizuar tërheqjet e njohjeve ndërkombëtare të disa shteteve kundër Kosovës. E tani, që taksa është në fuqi, është e udhës që Kosova ta kushtëzojë heqjen e saj me masa konkrete kundër Serbisë. "Shengeni ballkanik serbo-centrist" tenton që t'i bëjë presion Kosovës për heqjen e taksës në mënyrë të

pakushtëzuar, ose ta bëjë atë "fact accompli", përmes Tiranës zyrtare.

"Shengeni ballkanik" është i dëmshëm dhe i rrezikshëm për Ballkanin sepse synimi dhe formati i tij do t'i ngjallë problemet e fqinjësisë në Ballkan dhe do ta thellojë fragmentimin e tij. Duke u vënë në qendër të këtij "Shengenit ballkanik serbo-centrist", Serbia do të anashkalojë dhe jo t'i zgjidhë problemet serioze me fqinjët e saj. Deri tani Serbia është gjeneruese problemesh fqinjësore dhe pengesë bashkëpunimi ballkanik. Me gjithë fqinjët, në një masë apo tjetër, dhe me gjithë Ballkanin, në një fushë apo tjetër, Serbia është vetë problemi dhe jo zgjidhja. Fakti që fqinjët e drejtpërdrejtë të Serbisë, Mali i Zi, Kosova, Bosnje-Hercegovina dhe Kroacia kanë abandonuar këtë format "Shengeni ballkanik serbo-centrist", do të thotë se ato i njohin mirë problemet dhe vështirësitë që ka krijuar dhe vijon të krijojë Serbia me to dhe me mbarë Rajonin. "Shengeni ballkanik serbo-centrist" është i dëmshëm dhe i rrezikshëm edhe për mbarë Evropën. Në thelb ky lloj Shengeni serbo-centrist tenton t'i hapë portat Rusisë. Sa kohë politika dhe gjeostrategjia serbe është bivektorëshe euro-ruse, lypset të kuptohet se çdo hap i Serbisë me fqinjët, Ballkanin dhe Evropën, i hapë rrugën Rusisë për të depërtuar dhe për ta rritur praninë dhe ndikimin në fqinjët e Serbisë, në Ballkan dhe në mbarë Evropën. Serbia ka vendosur të jetë "Kali i Trojës" i Rusisë në Ballkan dhe në Evropë. Shengeni serbo-centrist tenton t'i krijojë hapësirë gjeopolitike dhe gjeostrategjike Rusisë, në një kohë kur Bashkimi Evropian po ashpëron strategjinë kundër ofensivës ruse në Evropë. Me pak fjalë, "Shengeni serbo-centrist" është gracka e radhës e Serbisë për ta izoluar Kosovën, për të dominuar fqinjët, për ta fragmentuar Ballkanin dhe për t'i hapur portat Rusisë si karshillëk kundër Bashkimit Evropian. Asgjë të drejtë, të arsyeshme dhe të dobishme nuk pritet të vijë nga "Shengeni serbo-centrist". Ky lloj "Shengenit" është një dublim i panevojshëm në termat evropiane. Por, është shumë i dobishëm në termat serbe-ruse.

NATO i bën thirrje Turqisë të ketë vetëpërmbytje

Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, e pranoi se Turqia ka shqetësime legjitime sigurie lidhur me luftëtarët kurdë të Sirisë, por paralajmëroi se ofensiva mund ta vinte në rrezik përparimin e bërë kundër grupit terrorist Shteti Islamik

ANKARA, 11 TETOR - NATO-ja po nxit Turqinë që të ushtrojë vetëpërmbytje në inkursionin në Sirinë verilindore.

Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, e pranoi se Turqia ka shqetësime legjitime sigurie lidhur me luftëtarët kurdë të Sirisë, por paralajmëroi se ofensiva mund ta vinte në rrezik përparimin e bërë kundër grupit terrorist Shteti Islamik.

Stoltenbergu foli në një konferencë për shtyp në Stamboll me ministrin e Jashtëm turk, Mevlut Cavusoglu. Cavusoglu tha se Turqia pret solidaritet nga NATO-ja lidhur me kërcënimet me të cilat përballlet.

Turqia ka njoftuar për viktimën e parë mes radhëve të ushtrisë, tri ditë pasi filloi inkursionin në Siri. Ministria e Mbrojtjes tha se tre ushtarë të tjerë janë plagosur, pa dhënë detaje të mëtejshme. Ka pasur njoftime edhe për viktima civile, por shifrat është vështirë të konfirmohen. Të premtën pati njoftime për shpërthime në qytetet kufitare siriane të Ras al Ainit dhe Tel Abyadit, ndërsa vazhdonte ofensiva ushtarake turke.

Komiteti Ndërkombëtar i Shpëtimit thotë se 64 mijë vetë janë zhvendosur dhe qindra mijëra të tjerë mund të bëhen të pastrehë së shpejti. Të dyja palët

njoftojnë për vdekje mes civilëve, ndërsa mortajat hidhen nga përtej kufirit në Turqi. "Avionët turq kanë goditur nga ajri, tha Diyar Ahmed, një zëdhënës i qeverisë autonome kurde në verilindje të Sirisë në një deklaratë të enjten. Në të njëjtën kohë, goditjet me artileri të rëndë nuk janë ndalur dhe ata nuk po e ndalin zjarrin ndaj fshatit dhe ka civilë të plagosur dhe të vrarë".

Zonë e sigurt

Turqia thotë se po lufton për të vendosur "një zonë të sigurt" mes kufijve të saj dhe Forcave Demokratike Siriane të udhëhequra nga kurdët, një grup që Turqia e konsideron organizatë terroriste.

Grupi kishte mbështetjen e Shteteve të Bashkuara, por të hënën presidenti Donald Trump deklaroi papritur tërheqjen e forcave amerikane nga Siria Verilindore, duke shkaktuar kaos në rajon.

Shtetet e Bashkuara fillimisht ndërmjetësuan për një version të zonës së sigurt në gusht dhe ranë dakord ta patrullonin me trupat turke, duke ndarë praktikisht Turqinë nga Forcat Demokratike Siriane, të cilat Turqia i konsideron njëloj si PKK-në, një grup ekstremist që ka kryer sulme në Turqi për dekada me radhë. PKK-ja është përcaktuar si grup terrorist edhe nga Bashkimi Evropian, ShBA-ja dhe vende të tjera.

Me largimin e forcave amerikane, Turqia deklaroi nuk mund "të priste asnjë minutë më shumë" për të filluar ato që i përshkroi si operacione anti-terrorizëm.

Trupat e Forcave Demokratike Siriane u zhvendosën në veri të zonave kufitare, duke i lënë qytetet, kampet dhe burgjet më të ekspozuara ndaj sulmeve të ISIS-it. Presidenti Trump u kritikua ashpër nga mbështetësit dhe kundërshtarët për braktisjen e aleatëve kurdë kundër ISIS-it në Siri, që humbën 10 mijë luftëtarë

nga radhët e tyre në luftime me grupin militant.

Qeveria turke thotë se miliona refugjatë që janë tani në Turqi do të vendosen në zonën e sigurt, ndërsa udhëheqësit kurdë thonë se vetëm refugjatët që janë nga ajo zonë e Sirisë do të lejohen të kthehen, nëse kontrollojnë zonën.

Rishfaqja e Shtetit Islamik

Që kur Trumpi deklaroi fillimisht planet për t'u tërhequr nga Siria vitin e kaluar, ekspertët kanë paralajmëruar se largimi i ShBA-së do të fuqizonte militantët e Shtetit Islamik. Dhe megjithëse militantët nuk kanë nën kontroll territor gjeografik, ata vazhdojnë të kryejnë sulme në zonat e kontrolluara nga SDF.

Në qyteti e Raqqa-s, dikur "kryeqyteti" i ISIS-it, banorët lokalë thonë se ISIS-i mund të kthehet në çdo kohë nëse forcat e sigurisë nuk janë vigjilente.

Pasi Turqia njoftoi për planet e saj ushtarake, SDF-ja i tërhoqi trupat nga Raqqa dhe qytete të tjera dhe e reduktoi sigurinë përreth burgjeve të Shtetit Islamik dhe kampeve ku janë dhjetëra-mijëra luftëtarë dhe familjet e tyre. Që atëherë ka pasur njoftime për deri tri sulme vetëvrasëse me bomba në Raqqa.

Dhe ndërsa Trumpi thotë se Turqia do të marrë përgjegjësi për të burgosurit e Shtetit Islamik, nuk është e qartë se në ç'menyrë duke pasur parasysh se ata mbahen aktualisht nga SDF-ja shumë më në jug të kufirit, sipas Grupit Ndërkombëtar të Krizave. Grupi thotë se konflikti mund të përfshijë edhe vende të tjera dhe Ushtrinë siriane, duke e intensifikuar përsëri luftën civile në vend. "Por cilido qoftë skenari, mundësitë që ISIS-i të rigjallërohet dhe të përhapë ndikimin e tij, do të shumëfishohet në proporcion me rritjen e dhunës dhe kaosit", thuhej në një deklaratë GNK-së të enjten.



Turkish Service (VOA)

Marie Yovanovitch dëshmon para komisioneve të Kongresit

UASHINGTON, 11 TETOR - Ish-ambasadorja amerikane në Ukrainë Marie Yovanovitch po dëshmon të premtën përpara komisioneve të Dhomës së Përfaqësuesve që po kryejnë hetime në kuadër të procesit për shkarkimin e presidentit Donald Trump.

Shtëpia e Bardhë ka refuzuar të bashkëpunojë, duke i cilësuar hetimet "jokushtetuese". Deri më tani Departamenti i Shtetit e ka bllokuar ambasadorin amerikan në Bashkimin Evropian Gordon Sondland që të

paraqitet për të dëshmuar vullnetarisht. Pas këtij zhvillimi, komisionet morën vendim ta thërrasin atë me detyrim.

Trumpi vazhdon t'i qëndrojë pozicionit se përmbajtja e bisedës së tij telefonike zhvilluar më 25 korrik me presidentin e Ukrainës Volodymyr Zelenskiy, e cila nxiti hetimet për shkarkim, nuk përbën asnjë problem ligjor. Një ditë më parë Zelenskiy deklaroi se nuk i është bërë "asnjë shantazh" gjatë telefonatës në të cilën Trump i kërkoi të nisë hetimin ndaj ish-nëpres-

identit Joe Biden dhe djalit të tij, Hunter. Pas komentit të Zelenskiy udhëheqësi amerikan u tha gazetarëve se presidenti i Ukrainës thjesht konfirmoi atë që ai ka thënë më parë dhe kërkoi që kësaj çështjeje t'i jepet fund.

Trumpi pretendon, por pa dhënë asnjë fakt, se gjatë kohës që Biden mbante detyrën e nënpresidentit kishte kërcënuar se do të ndalte ndihmën financiare për Ukrainën, nëse Kievi nuk ndalte hetimin ndaj një kompanie gazi ku Hunter Biden, ishte anëtar bordi.





AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë**

**Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.**

**Ju mirëpret:
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "**

Tel / kontakt:

044 248 173

044 200 604

044 375 333

E jashtëzakonshme

Zbulojnë peshkun që mbijeton jashtë ujit

Në shtetin Xhorxha të ShBA-së është zbuluar për herë të parë një lloj peshku që është i ri për zonën dhe që arrin të shtegtojë duke lëvizur qëllimisht dhe jashtë ujit pasi merr oksigjen nga flegrat e gushës. Por ngaqë është rrezik i madh për speciet vendase, autoritetet u



kanë bërë thirrje kujtdo që has peshq të tillë që t'i vrasin, për t'i shpëtuar të tjerët.

FOTO E DITES



Një djalë i veshur me një kostum Spidermani qëndron në rrugën e trenit popullor Hanoi në Vietnam. /AFP/

E rrallë

Kulla më e çuditshme në botë

Një kullë 137 metra e lartë mund të ndërtohet në Pragë dhe do të duket si një naftëmbajtëse që është duke u mbytur. Kompania Trigema mund ta ndërtojë në periferitë e Pragës, me një kosto prej rreth 80 milionë eurosh. Kulla do të kishte pamje 360 gradë dhe do të ofronte zyra, apartamente, dyqane dhe qendra multifunkionale. Ndërtuesit mund ta për-



fundojnë brenda vitit 2021, por projekti nuk është pëlqyer nga të gjithë.

BARSOLETA E DITËS



Në shkollë mësuesja po shpjegonte:
- Unë studioj, ti studion, ai ajo studion.
Çfarë kohe është, Toni?
- Është kohë e humbur kot, mësuese!



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Çdo ditë në ora 16:00 Toy Story 4 / 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi;
1 orë 40 min

Rolet: Tom Hanks (Woody), Annie Potts (Bo Peep), Tim Allen (Buzz Lightyear), Tony Hale (Forky), Keegan-Michael Key (Ducky), Madeleine McGraw (Bonnie), Christina Hendricks (Gabby Gabby), Don Rickles (Mr. Potato Head), Jordan Peele (Bunny), Wallace Shawn (Rex), John Ratzenberger (Hamm), Keanu Reeves (Duke Caboom), etj.

Regjia: Josh Cooley



Në ora 18:00 dhe 20:00

AD ASTRA

Aventurë/Dramë/Mister; 2 orë 04 min

Rolet: Brad Pitt, Tommy Lee Jones, Ruth Negga, Liv Tyler, and Donald Sutherland

Regjia: James Gray




Çdo ditë në ora 22:00

DOWNTON ABBEY

Dramë; 2 orë 02 min

Rolet: Hugh Bonneville, Jim Carter, Michelle Dockery, Elizabeth McGovern, Maggie Smith, Imelda Staunton, Penelope Wilton, etj.

Regjia: Michael Engler




Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe **boxoffice@kinoabc.info**, **www.kinoabc.info**, **fb: Kino ABC**.



DASHI
Paraditja parashikohet të jetë pak e mërzitshme.



DEMI
Personat të cilët nuk janë në një lidhje mund të përfshihen në disa aventura.



BINJAKËT
Pritshmëritë janë shumë të larta në aspektin sentimental, por rezultatet nuk janë ato që prisni.



GAFORRJA
Ditë e bukur për ta kaluar në shoqërinë e partnerit.



LUANI
Nëse jeni duke menduar që të bëni disa ndryshime në aspektin sentimental, mos hiqni dorë.



IRGJËRESHA
Sot do të jetë një ditë e përkryer për t'i bërë kritikë vetes dhe për të zbuluar disa anë të karakterit që duhen përmirësuar lidhur me partnerin.



PESHORJA
Bëni kujdes në komunikimin tuaj me partnerin.



AKREPI
Mund të keni nevojë për maksimumin e përqendrimit dhe të vullnetit për të zgjidhur ndonjë problem të vogël me partnerin.



SHIGJETARI
Mos lejoni që xhelozia të fitojë mbi ju. Largojini nga mendja mendimet e kota mbi tradhtinë.



BRICJAPI
Ajo që nuk ndodh prej shumë ditësh mund të ndodhë në një çast.



UJORI
Një situatë që e keni veçanërisht për zemër është e rikuperueshme.



PESHQIT
Mund të keni nevojë për maksimumin e përqendrimit dhe të vullnetit për të zgjidhur ndonjë problem të vogël me partnerin.

Daniel Hernandez nga burgu nënshkruan kontratë dhjetë milionëshe



Tekashi 6ix9ine ka nënshkruar një kontratë të re muzikore në burg. Marrëveshja me kompaninë e produksionit "10K Projektet" thuhet se vlen 10 milionë dollarë dhe është për dy albume, njëri në anglisht dhe një në spanjisht. Tekashi, emri i

vërtetë i të cilit është Daniel Hernandez, është në pritje të dënimit për akuzat për shantazh dhe armë zjarri në ShBA. Ai ishte dënuar me 47 vjet burgim përpara se të pranonte një marrëveshje për të dhënë informata për anëtarët e tjerë të grupit të vet.

Natalie Portman flet për miqësinë e saj qysh në fëmijëri me Britney Spearsin



Natalie Portman ka treguar për fillimin e miqësisë me Britney Spearsin pasi dyshja qysh në fëmijëri kishte punën e njëjtë. Aktorja 38-vjeçare zbuloi se ata e kishin kuptuar se ndanin të

njëjtin rol si fëmijë dhe u bashkuan në moshën 18-vjeçare për të bërë një festë së bashku. Pasi e kuptuan këtë ato u bashkuan në Mickey Mouse Club. Të gjitha këto ato i zbuluan tani për fansat.



Bella Hadidi e feston ditëlindjen me fustan të markës "Dior"

Bella Hadidi e ka festuar ditëlindjen e 23-të në një nga vendet më të njohura në Nju Jork, e veshur me një fustan të kohëve më të hershme me material kadifeje nga disenjatori John Galliano nga marka "Dior". Një fustan me dizajn të ngjashëm nga dekada e kaluar është aktu-

alisht në shitje për çmimin prej 2 754 dollarësh. Supermodeluesja e njohur e kishte kombinuar fustanin e ngushtë me ngjyrë të kuqe, rozë dhe të verdhë me një palë çizme, po ashtu retro nga "Paige" që kushtojnë 578 dollarë dhe një çantë të vogël.

Lupita Nyong tregon pse u refuzua të jetë pjesë e televizionit

Aktorja e njohur Lupita Nyong ka bërë me dije se dikur i është thënë që është "shumë e zezë" për të qenë pjesë e televizionit. Këtë e tha Nyong në një intervistë me Emily Maitlis dhënë "BBC"-së. "Një herë kam konkurruar në një audicion, aty më thanë se isha shumë e zezë për të qenë pjesë e televizionit", tha Nyong.



'Lirija', gazeta e ribotuar pas një shekulli

Mehdi GURRA

Ka pak kohë që lexuesve u është bërë e mundur të shfletojnë një gazetë të dalë këtu e më tepër se njëqind vjet më parë. Shumë prej shfletuesve të sotëm kanë një mundësi për ta shuar kureshtjen mbi nivelin gazetaresk të asaj kohe, mbi të shkruarit e shqipes dhe stilin e shkrimit të atyre që shkruanin atëbotë, mbi kornizat ideore të kohës, mbi botëkuptimet dhe afshet e atdhedashurisë të nxjerrësve në shtyp të gazetave, revistave dhe periodikëve sporadikë.

Botimi anastatik i gazetës "Lirija" e ka risjellë atë ashtu siç ishte në botimin e saj të parë, pa i ndryshuar asgjë. Botuesi është kujdesur kështu që gazetës të mos i cenohet asnjë element, qoftë dhe i jashtëm, estetik, për të mos e lënë atë pa atë magji që krijon ndjesinë e zhvendosjes në kohë mendërisht, bartur në një botë të ndezur nga ndryshimet e shfaqura në horizont.

Një përpjekje e përbashkët, e mirëpritur, e Fondacionit "ALSAR" dhe e Bibliotekës Kombëtare ka çuar gjer te ky botim anastatik. Është fjala për një bashkëpunim të konsoliduar pas një përvoje tepër pozitive me botimin anastatik më herët të revistës "Diturija".

"ALSAR" përbushoi një angazhim të marrë solemnisht, ndihmuar nga Biblioteka Kombëtare. Fondacioni ka hedhur baza të qëndrueshme në krijimin e një tradite të tij për të bërë botime të tilla. Bashkëpunimi me një institucion shtetëror si Biblioteka Kombëtare është dëshmuar si një element thelbësor në përmbylljen me sukses të këtij projekti. Ky bashkëpunim nuk do të kishte shkuar kaq mirë pa qasjen pozitive dhe angazhimin e sinqertë të ish-drejtoreshës së institucionit në fjalë, zonjës Persida Asllani. Ndihma e saj e drejtpërdrejtë është e pasqyruar në një shkrim ndriçues të kushtuar botimit dhe vetë gazetës si përmbajtje, gjendur në krye të materialit dhe shkruar qartas me zell e dashuri profesionale.

Me botimin anastatik të gazetës "Lirija" merr trajtë të plotë një cikël botimesh të këtij lloji të Fondacionit "ALSAR", ku përfshihen dhe revista "Diturija" e "Kalendari kombiar", duke na dhënë një panoramë të gjerë të lëvizjeve politike, intelektuale

dhe atdhetare të fillimit të shekullit të shkuar. Figurë qendrore e gati tre botimeve është Mid'hat Frashëri, me firmën autoriale si Lumo Skëndo. "Diturija" dhe "Lirija" janë pronë e tij, ngjizur e rritur me kujdes si drejtues dhe shkruar në to.

Përfitimi i lexuesve është në këtë mënyrë i dyfishtë, posaçërisht i studiuesve të një kohe intensive në mbujtjen e ndërgjegjes kombëtare. Së pari, me botimin anastatik të gazetës "Lirija" mund të krijohet një perceptim shumë më i plotë për përpjekjet intelektuale të një numri lëvrueshish të publicistikës në vitet që i paraprind shpalljes së pavarësisë, mund të pikasen më nga afër shqetësimet e tyre shoqërore, mund të dallohet shpirti i tyre poetik.

Së dyti, shfletimi i botimit anastatik të gazetës "Lirija" na jep një tjetër rast për ta çmuar objektivisht trashëgiminë publicistike të Mid'hat Frashërit. Një varg aktiviteteve dhe botimesh një vit më parë në kuadër të rivlerësimit të figurisë dhe veprës së tij krijuan dhe polemikë, buruar prej atyre që qëndrimet politike të mëvonshme të këtij veprimtari, përgjithësisht gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe pas saj, i kanë parë si tejet negative. Krejt e natyrshme që një njeri me një aktivitet të tillë tepër të gjallë, të ngjeshur dhe të larmishëm, të ketë krijuar miq dhe armiq në të gjallë të tij dhe pas ikjes nga kjo botë. "Lirija" ua bën të mundur të dyja palëve që ta kundrojnë më mirë Lumo Skëndon, drejtonjësin e saj, t'ia vlerësojnë nga qasjet e tyre pikëpamjet dhe të shkruarën.

"Lirija" është një thesar i vogël publicistik. Është thesar sepse në të gjen shumëçka të lëvruar; është i vogël ngaqë gazeta e pati jetën jo fort të gjatë, vetëm diçka më tepër se dy vite, gati tridhjetë muaj.

Botimi anastatik i ka të tërë numrat e gazetës, nga i pari, i dalë më 14 korrik 1908, te i fundit, nxjerrë nga shtypi më 25 dhjetor 1910. Një shumëllojshmëri materialeve gjendet në to: kryeartikuj qëndrim mbajtës dhe shpesh të ashpër, letra të hapura, herë-herë denoncuese, analiza, portrete njerëzish me emër, reportazhe, udhëpërshkrime, shqipërime, poezi të këndshme që i këndojnë dashurisë, prozë të shkurtër, njoftime për botime të reja, lajmërimi shërbimesh... Theksi



mbi çështjen e gjuhës shqipe është i fortë, i mprehtë. Kongresi i Manastirit, mes të tjerash, trajtohet gjerë e gjatë, dhe për punimet e tij ka raportim të hollësishëm.

Ç'ka në të "Lirija" na e thotë një njoftim i vetë gazetës në numrin e saj të 96-të për një koleksion të saj: "Këto... janë si një histori e mbaruar për ngjarjet e Shqipërisë: n'ato numra do të gjendet çdo punë, çdo mendim, çdo punë e kombit tonë. Dhe kështu, ata që duan dokumente të vërteta do të gjejnë një burim të begatshëm".

"O vëllezër! Dëgjoni të them dhe unë dy fjalë shqip: Sot na erdhi ajo ditë e lirisë që e prisnim që kaq kohë..., sot na erdhi ajo ditë e bukur..., sot lindi dielli i bukur i lirisë," janë rreshta në numrin e parë të gazetës. Ngazëllimi vjen prej shpalljes së kushtetutës ato mote: "Gazi që po ndjen tani gjithë Turqia është se u dha konstitucioni. Po ç'është konstitucioni dhe ç'të mira na sjell?"

"E nisur si lëvizje reformatore prej disa dekadash, por e realizueshme më në fund vetëm përmes një revolucioni ku shqiptarët dhanë një kontribut thelbësor, Kushtetuta premtonte garantimin e një sërë lirisish dhe për popujt e tjerë të

gjitha ato shkolla që janë në Shqipëri dhe që paguhen prej qeverisë..."

Ngjall interes në numrin e dhjetë të gazetës një letër e hapur e Mid'hat Frashërit për "Ismail Qemal beun nga Vlora", për ta cituar siç është në origjinal. Një letër me një përmbajtje mjaft të ashpër, që duhet lexuar gjithësesi. Në lidhje me këtë letër ndesh në numrat pasues shpjegime të autorit të saj, në përgjigje të reagimeve të ndryshme të cilat ai i përmend.

Numri i 13-të i gazetës hapet me artikullin "Shkollat shqip", nga i cili veçojmë: "Shqipja jonë... sot mund të lëshojë krahët dhe të fluturojë e çliruar. Sot mund të kemi sa shkolla të duam..."

"Grekërit dhe shqiptarët" është një artikull i numrit 45, që u kujton fqinjëve tanë jugorë se, "duhet ta dinin se nga miqësia e shqiptarëve mund të kenë fitim të madh, dhe nga armiqësia e tyre dëm të fortë". Me titullin "Çështja e shkollave shqip" hapet numri 70 i gazetës; dy numra më pas titulli kryesor është, "Gjuha shqipe dhe fetë".

Vargjet poetike në faqet e gazetës i japin asaj atë butësi dhe këndshmëri të nevojshme për ta bërë më tërheqëse, më të kërkuar. Vargjet, "Larg mëmëdheut i mërguar, me hidhërim mbushur plot, ditë e natë rri menduar, oh vallë a do kthehem dot," i ndeshim në numrin 46. Po aty i këndohet dashurisë, "Në kujton Zotin e Perëndinë, në ke një dhimbje në zemrën tate, falma të lutem dashurinë, të rrojmë si mendu s'e pate".

"Lirija" ishte një gazetë me vetëm katër faqe, modeste për nga përmasat, e madhe për nga tematikat. Ajo duhet t'ia ketë dalë në kohën e vet që t'i ketë ndërgjegjësuar sadopak njerëzit për hallet e vendit, për hallet e tyre brenda dhe jashtë pragut të shtëpisë; shumë prej atyre dertëve nuk kanë gjetur zgjidhje as sot.

Vështruar nga një kënd i caktuar, "Lirija" është një leksion i vërtetë për gazetarinë: si të thuash aq shumë gjëra në aq pak faqe, si të ruash seriozitetin dhe të mbash larg banalitetin në informimin e publikut, si të ndërthurësh politiken me letraren, atdhetaren me emocionet më të thjeshta njerëzore...

Si një botim anastatik, "Lirija" është një pjesëz e rifreskuar e trashëgimisë sonë publicistike!

Preshi - Vlerat për shëndetin dhe pse duhet ta konsumoni

Superperimeje janë të nënvlerësuara

Por padyshim i njohin mirë Grekët e Lashtë, Romakët dhe Egjiptianët përshembull, që i jepnin preshit kredite për vlerat e tyre terapeutike. Perandori romak Nero gjithashtu e pinte dëndur lëngun e preshit për të forcuar zërin. Ndërkohë që ne shqiptarët, preshin e përdorim në shumë mënyra; të gatuar në supë, ashtu të gjallë apo në lakrorin karakteristik që njihet në botë për vulën e tij "Made in Albania".

Sepse preshi ka aq shumë të mira shëndetësore sa që nuk mund të injorohet.

Ato fillojnë që nga lehtësimi i dhembjeve të fytyrës, tek mbajtja larg e gurëve në veshka, deri te luftimi i qelizave të dëmshme, sa për të përmendur disa syresh. Dhe padyshim ajo që është e mirë për shëndetin, shpesh ndodh të jetë e mirë edhe për biznesin.

Kështu thotë për AgroWeb.org edhe Kujtim Lika, i cili e eksporton këtë perim në rajon. "Preshi hyn padiskutim në familjen e perimeve për të cilat ka më shumë kërkesë", thotë Lika për Agroweb. Ai e eksporton preshin shqiptar kryesisht në Poloni, Bullgari, Bosnjë Hercegovinë dhe Ukrainë.

Preshi është shumë rezistent ndaj të ftohtit dhe ngricave. Ai ka mundësi që të kultivohet deri nga fundi i muajit prill pothuajse në shumë zona të vendit.

Prodhimin më të madh e ka zona e Lezhës me 600 kv dhe Tirana me 300kv, duke u eksportuar përgjatë të gjithë dimrit dhe pranverës.

"Ne eksportojmë në të gjithë rajonin", thotë për AgroWeb.org, Saimir Biti një tjetër eksportues duke pohuar se kërkesa për këtë perim ka ardhur në rritje.

"Do të thoja madje dhe më shumë se lulëllakra, karrota apo kungulli. Gjatë kohës së komunizmit preshi ishte një nga perimet me prodhimtari dhe eksport të lartë.

Në Shqipëri një kilogram presh shitet mjaft lirë, ndërkohë që në Britaninë e Madhe përshembull çmimi shkon në 400 lekë për 400 gramë presh dhe në Shtetet e Bashkuara shifra mund të shkojë deri 1300 lekë për 1 kg.

Po, është kaq i shtrenjtë për shkak dhe të vlerave të mëdha që ka si perim.

Tretet shumë më shpejt se qepët dhe ka vlera laksative, antiseptike, diuretike dhe ndihmon kundër artritit.

Dhe nëse konsumohen rregullisht të ndihmon të jesh në formë dhe i shëndetshëm.

Shikoni se çfarë i bën preshi trupin tonë dhe do të fluturon drejt tregut për ta blerë.



agroweb.org

1 pras përmban:

17 KALORI
1g PROTEINË
0.6g YNDYRNA
2.1g KARBOHIDRATE
1.4g FIBRA

Ndihmon në funksionimin e mirë të veshkave

Duke qenë se preshi përmban 1/8 e e sasisë ditore të potasit që duhet të marrë një i rritur, inkurajon në funksionimin e mirë të veshkave duke shërbyer si diuretik.

Presh për një zemër të shëndetshme

Ngrënia e preshit ka treguar se ul kolesterolin e keq dhe në të njëjtën kohë rrit kolesterolin e mirë.

Kjo është shumë e rëndësishme për të parandaluar trashjen e pllakave të enëve të gjakut që gjenden në disa lloj sëmundjesh.

Nëse pllakat trashen shumë apo këputen ato mund të shkaktojnë atak kardiak ose hemoragji.

Perimet e familjes allium, ku përfshihet dhe preshi ndihmojnë në uljen e presionit të gjakut, një faktor tjetër që kontribuon në sëmundjetardiak.

Për stabilizimin e sheqerit në gjak

Preshi është një burim shumë i mirë me manganez dhe vitaminë B6, vitaminë C, folat dhe hekur.

Të gjithë këto ushqyes veprojnë në trupin e njeriut duke stabilizuar sheqerin në gjak. Po ashtu duke ulur përthithjen e sheqerit nga trakti tretës.

I shkëlqyer dhe për nënat shtatzëna

Preshi është një burim shumë i mirë me vitaminë B dhe folat. Folati është shumë i rëndësishëm për gratë shtatzëna duke ulur rrishtun për defektet e shtyllës kurizore.

Një porcion me presh të gatuar përmban gati 1/3 e sasisë së folatit të rekomanduar për konsum nga një i rritur.

Për një dietë të shëndetshme

Preshi është një zgjedhje e shkëlqyer për të gjithë ata që duan të ndjekin një dietë të shëndetshme, duke qenë se ka pak kalori dhe është plot me vitamina e minerale. / AgroWeb.org



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

Sermaxhaj: Ndashje e bukur ndaj Gjibraltarit, pres fitore ndaj Malit të Zi

Analisti dhe trajneri i futbollit Genc Sermaxhaj ka thënë të premtën për "Epokën e re" se paraqitja dhe fitorja ndaj Gjibraltarit ishte e bukur nga ana e Kosovës, derisa pret që e njëjta gjë të ndodhë edhe të hënën në kualifikuesen ndaj Malit të Zi.

"Pavarësisht se shënuam vetëm një gol, loja ishte e dominuar në të gjitha anët dhe njësoj duhet të vazhdojmë edhe ndaj Malit të Zi", ka thënë Sermaxhaj



'Dardanët': Nuk do ta ofendojmë Malin e Zi

Kosova të hënën vndeshjen e rëndësishme për kualifikim në "Euro 2020" ndaj Malit të Zi. "Dardanët" kanë njoftuar se nuk do ta ofendojnë kundërshtarin. "Të hënën, më 14 tetor, në stadiumin 'Fadil Vokrri' Kosova përballet me Malin e Zi, ndeshje kjo që mund të jetë vendimtare për rrugëtimin e Kosovës në 'Euro 2020'. Me besimin në fitore, ne 'Dardanët' do t'i përkrahim djelmoshat tanë prej sekondës së parë e deri në fund", thuhet në njoftimin e "Dardanëve". "Me besimin se kështjella e quajtur 'Fadil Vokrri' mbetet e pamposhtur, ne do të jemi lojtari i 12 i Kosovës. Me besimin në djemtë tanë në krye me Challandesin, nuk do të ndalemi së brohorituri. Njëkohësisht, siç e kemi traditë, nuk do ta ofendojmë kundërshtarin. Kemi dhënë besën. Për Kosovën, dashurinë tonë të përjetshme", thuhet më tej në njoftimin e "Dardanëve".

Evropian. Ish-reprezentuesi i Kosovës, Genc Sermaxhaj, është optimist se fitorja do t'i takojë Kosovës. "Kjo ndeshje është e rëndësishme dhe duhen shfrytëzuar rastet që i sjell loja, futbollistët duhet të jenë më të koncentruar dhe të arrijnë fitore. Presim të kthehen në lojë edhe lojtarët startues dhe të kompletë ekipi për këtë ndeshje dhe të arrijmë fitore përmes lojës së bukur e shumë atraktive që Kosova ka aplikuar deri më tani. Besoj në fitoren e Kosovës.

Gjithsesi duhet kujdes maksimal ngaqë futbollit sjell shumë të papritura shpeshherë", ka shtuar Sermaxhaj.

Në ndeshjen e parë të zhvilluar në Mal të Zi Kosova arriti të nxjerrë barazim (1-1), kurse tash llogaritet favorit për ndeshjen që e zhvillon në stadiumin "Fadil Vokrri", ku edhe pritet ta ketë përkrahjen e 13 mijë tifozëve. Aktualisht skuadra përfaqësuese që drejtohet nga përzgjedhësi Bernard Challandes është e treta në grup me tetë pikë të grumbulluara.

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 11 SHTATOR - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll e fitoi të enjten miqësoren ndaj Gjibraltarit (1-0). Analisti dhe trajneri i futbollit, Genc Sermaxhaj, ka thënë të premtën për "Epokën e re" se rëndësi ka fakti që Kosova luajti bukur edhe pse kishte shumë ndryshime në formacion. Sermaxhaj ka shtuar se rezultati 1-0 nuk ishte real për epilogun përfundimtar të kësaj ndeshje sepse "dardanët" kanë krijuar shumë raste dhe kanë dominuar ndaj kundërshtarit në të gjitha format. "Kosova ndaj Gjibraltarit vazhdoi ecurinë e ndeshjeve të bukura e

cilësore, ngjashëm si ndaj çdo kundërshtari tjetër, ani pse ishte në formacion me shumë lojtarë të tjerë që kanë pasur me pak minuta në fushë. E rëndësishme është mënyra e njëjtë e lojës edhe me lojtarët e tjerë dhe kjo tregon qartë se në përfaqësuese kushdo që luan duhet t'i kryejë detyrat e njëjta të cilat i kërkon trajneri Bernard Challandes. Pavarësisht se shënuam vetëm një gol, loja ishte e dominuar në të gjitha anët dhe njësoj duhet të vazhdojmë edhe ndaj Malit të Zi", ka thënë Sermaxhaj.

Kosova ndeshjen e radhës e zhvillon të hënën ndaj Malit të Zi, e cila është e vlefshme për grupin A kualifikues për Kampionatin

'Dardanët' e rinj vazhdojnë përgatitjet, paralajmërojnë fitore ndaj Shqipërisë

PRISHTINË, 11 TETOR - Përfaqësuesja U21 e Kosovës në futboll ka zhvilluar të premtën seancën e tretë stërvitore në kuadër të përgatitjeve për ndeshjen kualifikuese kundër Shqipërisë, e cila do të zhvillohet në Elbasan më 15 tetor. "Dardanët" e rinj, nën udhëheqjen e përzgjedhësit Rafet Prekazi dhe ndihmësve të tij, Erdogan Celina e Naser Prapashtica, kanë stërvitur me intensitet të plotë në stadiumin e Feronikelit. Sipas njoftimit të Federatës së Futbollit të Kosovës, atmosfera brenda



ekipit është e shkëlqyeshme dhe të gjithë futbollistët janë në formë të mirë dhe po punojnë me përkushtim të madh, derisa

kontingjentit të futbollistëve iu kanë bashkuar edhe Lirim Kastrati dhe Arbenit Xhemajli, të cilët luajtën me Përfaqësuesen A në miqësoren kundër Gjibraltarit. Në stërvitjen e fundit është punuar në të gjitha aspektet e lojës, derisa janë provuar edhe skema të ndryshme të lojës. "Është një ndeshje ndryshe nga të tjerat, ngaqë në fushë të gjithë do të jemi vëllezër të një kombi. Mirëpo, kur të zbrisim në fushë kjo nuk na intereson, pasi e kemi një objektiv para vetës për ta fituar ndeshjen dhe për ta vazhduar

ëndrrën e kualifikimit në Evropian. Sigurisht se do të jetë ndeshje e vështirë dhe Shqipëria do ta japë maksimumin, por ne synojmë ta bëjmë lojën tonë dhe shpresoj se gjithçka të shkojë siç duhet. Mendoj se pika jonë e fortë është fakti se luajmë me zemër, kemi cilësi dhe e lëmë shpirtin në fushë për 90 minuta", ka thënë Eris Abedini pas stërvitjes.

Për ndeshjen ndaj kuqezinjve të rinj foli edhe sulmuesi i Kukësit, Mirind Daku. Edhe Daku e parashikon si një ndeshje interesante dhe të vështirë për të dyja

skuadrat. "Duke pasur parasysh se jemi dy kombëtare shqiptare normalisht se do të jetë ndeshje emocionale për të dyja palët. Sigurisht se do të jetë ndeshje shumë e fortë, por besoj se do të ketë korrektësi maksimale. Ne duhet të hyjmë si në çdo ndeshje tjetër me motiv të plotë për të fituar. Prioritet për ne është arkëtimi i tri pikëve të reja në mënyrë që ta ndjekim ëndrrën e kualifikimit. Ka lojtarë që i njoh te Shqipëria, por i besoj shumë këtij grupi të futbollistëve dhe jam i bindur se do të arrijmë fitore", ka thënë Daku.

Skuadrat mysafire presin fitoret e radhës

PRISHTINË, 11 TETOR - Plot katër ndeshje të Superligës së Kosovës në hendboll (meshkujt) luhen sot (e shtunë). Në tri prej ndeshjeve skuadrat mysafire llogariten favorite. Kampionia aktuale, Besa Famgas, e hap javën e tretë me ndeshjen që e luan në Gjakovë ndaj Vëllaznimit. Kjo ndeshje fillon në orën 14:30, kurse klubi pejan nuk pritet të ketë vështirësi të

mëdha për të shënuar fitore të re. Dy ndeshje të tjera zhvillohen nga ora 18:00. Në Gjilan takohen Drita e Kastrioti i Ferizajt, kurse në Prizren luajnë Prizreni dhe Prishtina. Rivalitet më i madh pritet në takimin Drenica - Llapi që luhet po të shtunën nga ora 19:00. Ndashja më interesante e javës pritet të jetë ajo që luhet të dielën nga ora 17:00 në Mitrovicë. Takohen Trepça e

Vushtrria, që gjithnjë tregojnë hendboll të mirë dhe rivalitet sportiv në ndeshjet mes tyre. Edhe në Ligën e Parë të hendbollistëve zhvillohet java e tretë. Të shtunën është ndeshja Rahoveci - Samadrexha (19:00), kurse të dielën janë takimet Lepenci - Vjosa (12:00) dhe Deçani - Zhegra (13:30). Dukagjini dhe KEK-u do të përballen të mërkurën.



Curry: Dua sërish trofeun MVP

OAKLAND, 11 TETOR - Stephen Curry është në formë. Pak javë para fillimit të sezonit 2019-2020 të NBA-së, basketbollisti i Golden State Warriors ka realizuar 40 pikë në 25 minuta lojë,

në miqësoren që ekipi i tij fitoi ndaj Minnesotas me shifrat 143-123. Këtë sezon Curry do ta mbajë peshën më të madhe të skuadrës, duke parë dëmtimin e Klay Thompsonit dhe largimin e

Kevin Durantit. "Kjo gjë s'më tremb, jam mësuar edhe më parë. Jam gati ta jap kontributin tim", u shpreh 31-vjeçari, me tre tituj kampionë në NBA. Curry shpalos objektivin e tij: "Dua

trofeun MVP. Do ta bëj maksimumin për ta marr. Natyrisht se edhe titullin kam në plan". Talenti i NBA-së e ka fituar dy herë trofeun MVP (2015 dhe 2016).



Sot dy ndeshje, nesër derbi Rahoveci - Bashkimi



PRISHTINË, 11 TETOR - Këtë fundjavë do të zhvillohen ndeshjet e xhiros së pestë të Superligës së Kosovës në basketboll. Sfidat më interesante shihen ajo ndërmjet Rahovecit dhe Bashkimit, që zhvillohet të dielën mbrëma nga ora 19:00. "Vreshtarët" kanë dy fitore në dy ndeshje, kurse prizrenasit dy fitore dhe një humbje nga tri takime të zhvilluara. Xhiroja hapet me takimin ndërmjet Pejës dhe Lipjanit, ku pejanët shihen favoritë për të fituar, ndërsa lipjanasit kanë katër humbje nga katër ndeshje. Të shtunën, gjithashtu, Sigal Prishtina shihet favorite kundër Feronikelit. "Bardhekaltrit" kanë dy fitore dhe një humbje, kurse skuadra nga Drenasi ka tri humbje nga tri ndeshje. Ndeshje interesante është edhe ajo ndërmjet Ponte

Prizrenit dhe Trepçës, ku prizrenasit kanë dy fitore dhe dy humbje, kurse mitrovicasit dy humbje nga dy ndeshje. Në kuadër të javës së pestë të shtunën takohen: Peja-Lipjani (17:00), Sigal Prishtina-Feronikeli (19:00), kur të dielën në program janë: Ponte Prizreni-Trepça (17:00), Rahoveci-Bashkimi (19:00). Skuadra e Golden Eagle Ylli pushon në këtë xhiro.

Sot fillon Superliga e femrave

Këtë fundjavë do të fillojë Superliga e Kosovës në konkurrencën e femrave. Në këtë edicion për herë të parë gjashtë skuadra do të jenë në Superligën e Femrave dhe gjashtë në Ligën e Parë të Femrave. Një skuadër do të

luajë 20 ndeshje gjatë edicionit të rregullt dhe më pas zhvillohen përfundimtare. Katër skuadrat e para sigurojnë "play-off"-in, derisa skuadra e fundit (6) bie në Ligën e Parë. Pra, në edicionin e ri priten ndeshje shumë interesante dhe garë për çdo pozitë, derisa e gjitha kjo është bërë që të ketë më shumë interesim në basketbollin e femrave në Kosovë. Edicioni i ri hapet me ndeshjen ndërmjet Kastriotit dhe Penzës, që zhvillohet të shtunën nga ora 12:00, kurse të dielën Mabetex Prishtina është mysafir i Vëllaznimit. Ndeshja Bashkimi-Trepça zhvillohet të mërkurën. Të shtunën takohen: Kastrioti-Penza (12:00), kurse të dielën takohen: Vëllaznimi - Mabetex Prishtina (14:00), dhe të të mërkurën e ardhshme takohen: Bashkimi-Trepça (15:00).

Ferizaj në 'krizë', afër bojkotit

FERIZAJ, 11 TETOR - Skuadra Ferizaj mund të futet në bojkot, pasi lojtarët janë duke kërkuar të kryhen obligimet financiare ndaj tyre. Sipas njoftimit të klubit, investitorët anglezë ende nuk e kanë ndihmuar klubin financiarisht. "Futbollistët e skuadrës sonë janë duke kërkuar pagat e veta. Problemet financiare janë duke e përcjell klubin tonë edhe në këtë kampionat, edhe përkundër premtimeve të shumta. Ndërsa investitorët anglezë ende nuk kanë shprehur gatishmërinë për t'i ndihmuar klubin tonë me mjete financiare, ata po japin vetëm premtime të kota. Sipas informacioneve brenda klubit, nëse futbollistët pagat nuk i marrin me kohë,



mund të vijë edhe tek më e keqja, bojkoti nga futbollistët. Siç ka ndodhur edhe në vitet e kaluara, po përsëritet edhe këtë vit: vonesat e pagave për futbol-

listët të cilët janë të pakënaqur me gjendjen e klubit. Në ditët në vazhdim do të shikohet se çfarë do të ndodhë", thuhet në njoftimin e skuadrës së Ferizajt.

SHKURT

Southgate përmend sërish tre golat e pësuar nga Kosova

Trajneri i Anglisë, Gareth Southgate, ka thënë se një muaj ka qenë në humor të keq pasi pësuan tre gola në ndeshjen ndaj Kosovës (5-3). "Njëra prej vështirësive të punës është që ne po flasim për ndeshjen kundër Kosovës dhe ne nuk ishim të kënaqur nga ajo lojë. Kështu, fituam 5-3 dhe kam qenë në humor të keq për një muaj", ka thënë Southgate.

Juve vazhdon interesimin për Pogban

Kampioni në fuqi i Italisë, Juventus, është duke e vazhduar interesimin për mesfushorin Paul Pogba. Francezi, që është pjesë e Manchester Unitedit, duket se nuk është i lumtur në "Old Trafford" dhe kjo e bënë edhe më të mundshme mundësinë që ai të rikthehet në Itali. Mediet italiane kanë raportuar se "Zonja e Vjetër" është gati t'i ofrojë Mario Mandzukiqin dhe Emre Can, kurse në verë të ofrojë edhe një shumë prej 80 milionë eurove. 26-vjeçari ka qenë pjesë e Juventusit nga viti 2012 deri në vitin 2016, kurse ka regjistruar 124 paraqitje dhe ka shënuar 28 gola.

Lacazette kushton 120 milionë euro

Arsenali e ka vendosur çmimin për shitjen eventuale të sulmuesit francez, Alexandre Lacazette. Me këtë rast, klubet e interesuara për sulmuesin francez duhet t'i paguajnë hiç më pak se 120 milionë euro. Në fakt, menaxheri i futbollistit, Dmitry Chelstov, ka thënë se klubi anglez duhet ta lëshojë lojtarin për një shifër prej afro 50 milionë eurosh. Mirëpo, Arsenali insiston se për përfaqësuesin francez do ta kërkojë më shumë se njëfishin e kësaj shume. Për Lacazetten nuk është vendosur ndonjë klausolë për shkëputjen e kontratës, por "Topçinjtë" janë të vendosur të mos shesin atë për një çmim nën 100 milionë euro.

Zyrtare: Ranieri, trajner i Sampdorias

Sampdoria e ka zyrtarizuar trajnerin e ri, i cili do të jetë Claudio Ranieri. 67-vjeçari rikthehet në Itali, ku për herë të fundit e kishte drejtuar Romën sezonin e shkuar. Për stolin e Sampdorias u përfolën edhe emrat e Gianni De Biasit si dhe Genaro Gattusos, por në fund presidenti Ferrero vendosi për Claudio Ranierin, i cili do të përfitojë deri në fund të sezonit 1 milion euro. Italiani zëvendëson Di Francescon, për të cilin po kthehet në makth, pasi edhe te Roma e zëvendësoi një sezon më parë.

Tottenhami planifikon largimin e tre lojtarëve

Drejtuesit e Tottenham Hotspurit po përgatiten t'i largojnë disa lojtarë me hapjen e afatit kalimtar të janarit. Përveç Eric Dier apo Dany Rose, një emër me peshë që pritet të largohet nga "Spurs"-at është ai i mesfushorit danez Christian Eriksen. 27-vjeçarit i përfundon kontrata qershorin e ardhshëm dhe për të mos e humbur me parametër zero, Tottenhami është i bindur që ta shesë atë në janar. Erikseni është një nga objektivat e Real Madridit dhe kjo duket të jetë arsyeja se përse danezi nuk pranoi ta rinovonte kontratën.

Ozili merr oferta nga Turqia dhe Italia

Klubet e mëdha italiane të Serisë A janë futur në garë për mesfushorin e Arsenalit, Mesut Ozil, i cili e ka humbur vendin e titullarit dhe kohë pas kohe po mbetet edhe jashtë skuadrës së "Topçinjeve" këtë sezon. Fenerbahçe ka shfrytëzuar këtë situatë duke filluar negociatat me Arsenalin për një marrëveshje huazimi për mesfushorin gjerman. Por, sipas mediumit italian "Calciomercato.it", për yllin gjerman kanë shprehur interesim edhe nga klubet e mëdha të Serisë A. Interi, Milani dhe Napoli janë të gjithë të gatshëm të bëjnë një lëvizje për Ozilin në afatin kalimtar të janarit.


TrafikuUrban

Në bazë të nenit 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, të Republikës Kosovës, nenit 4 pika 1,2,3,4 dhe 5 dhe nenit 5 të Udhëzimit Administrativ nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenit 8 pika 1 (a), nenit 10 pika 1,5 dhe 11 pika 1 c Rregullores nr.1074 të datës 21.08.2017 mbi Marrëdhënien në Punë, Vendimi nr.3603 të datës 11.10.2019, NPK."Trafiku Urban" SIA.- Prishtinë, më datë 11.10.2019 shpall:

K O N K U R S

Pozitat e punës:

1. Pastrues Autobusi – 9 pozita
2. Aotomcanik – 3 pozita
3. Autoelektricitist – 1 pozitë
4. Autongjyrosës – 1 pozitë
5. Depoist Ndërrimi – 1 pozitë
6. Shofer Autobusi – 15 pozita
7. Diçer Linje – 3 pozita
8. Punëtor Sigurimi – 4 pozita

Kohëzgjatja e kontratës: 1 vit, me mundësi vazhdimi;

Orari i punës: I plotë;

1. Detyrat dhe Përgjegjësitë - Pastrues Autobusi:

- Bëhë pastrimin e autobusëve të N.P.K. "Trafiku Urban" në Prishtinë.
- Pastrimi bëhet sipas planit operativ të hartuar nga MTO.
- Pastron pjesët e brendshme të autobusëve nga mbeturinat dhe pluhuri sipas rendit kronologjik që vijnë ata në vendin e caktuar për pastrim.
- Pastrimi i autobusëve bëhet çdo ditë – me gjokër brenda autobusit dhe me spërkatje me ujë jashtë autobusit.
- Ditëve të vikendit të shtunave dhe të dielave bëhet pastrimi gjeneral i autobusëve
- Pastrimi bëhet me kujdes që mos të dëmtohen kamerat dhe pajisjet tjera elektronike Për çdo prishje të pajisjeve elektronike të shkaktuar nga mos kujdesi gjatë larjes, mbani përgjegjësi – shpenzimet për eliminim të defektit i bartë vet punëtori-ja.
- Kryen edhe punë të tjera sipas urdhrat të udhëheqësit të mirëmbajtjes, drejtorit teknik, dhe Kryeshefit Ekzekutiv të Ndërmarrjes, para të cilit është përgjegjës.

Dokumentacioni i kërkuar:

1. Aplikacionin për punësim;
2. Kopje të letërnjoftimit;

2. Detyrat dhe përgjegjësitë - Aotomekanik

- Pas pranimit të detyrave nga inxhinieri i Makinerisë, duhet të angazhohen në kryerjen e detyrave për riparimin e autobusëve që janë në pritje për riparim duke u bazuar në urdhëresa për punë,
- Ngarkohet me pjesë dhe vegla pune, të cilat i ka kërkuar nga depoja si dhe pajisje të tjera, duke respektuar procedurat e pranim dozimit,
- Bashkë me inxhinierin riparon dhe merr pjesë të drejtpërdrejt në riparim dhe identifikon problemin e autobusit, të gjitha punët e kryera duhen të përcillen me proceduar përkatëse,
- Është përgjegjës për riparim të shpejt dhe profesional të autobusit, i cili me shkrim e konfirmon pjesëmarrjen e tij,
- Kontrollon gjendjen ne hapësirën e punës dhe është përgjegjës për pastërti në punishte,
- Regjistron harxhimin e materialit dhe pjesëve rezervë dhe është përgjegjës për to, bën arsyeshmërinë e montimit e çdo pjese, kujdeset për kursimin e materialit, duke respektuar procedurat përcjellëse,
- Jep përgjegjësi dhe llogari për punë e kryer dhe duhet të jetë i disiplinueshëm në punë duke respektuar rregulloret,
- Mbanë evidencën për çdo autobusë që e ka riparuar dhe e mban evidencën në mënyrë profesionale, shënimin e km se kur ka intervenuar në autobusë, kontrollon dhe vërteton çdo defekti në autobusë,
- Kryen edhe detyra tjera që lidhen me përshkrimin e detyrave të punës si dhe detyrave të ngarkuara nga Udhëheqësi i Mirëmbajtjes.
- Për punën e vetë i jep raport me shkrim te inxhinieri,
- Raporton te udhëheqësi i mirëmbajtje dhe inxhinieri të makinerisë.

Kriteret dhe Dokumentacioni i kërkuar:

1. Shkolla e mesme apo fillore;
2. Aplikacionin për punësim;
3. Kopje të letërnjoftimit;
4. Përvojë punë përparësi;

5. Dëshmi mbi përvojën e punës;

3.Detyrat dhe përgjegjësitë – Autoelektricitist

- Pas pranimit të detyrave nga Inxhinieri i Makinerisë, duhet të angazhohen në kryerjen e detyrave për riparimin e autobusëve me defektet të elektrikes, që janë në pritje për riparim duke u bazuar në defektet e identifikuar.
- Ngarkohet me pjesë dhe vegla pune, të cilat i ka kërkuar nga depoja si dhe pajisje të tjera, duke respektuar procedurat e pranim dozimit.
- Bashkë me inxhinierin riparon dhe merr pjesë të drejtpërdrejt në riparim dhe identifikon problemin e elektrikes së autobusit.
- Është përgjegjës për riparim të shpejt dhe profesional të defekteve të natyrës elektrike dhe elektronike.
- Kontrollon gjendjen ne hapësirën e punës dhe është përgjegjës për pastërti në vendin e punës.
- Regjistron harxhimin e materialit dhe pjesëve rezervë, bën arsyeshmërinë e montimit e çdo pjese, si dhe kujdeset për kursimin e materialit, duke respektuar udhëzimet e eprorit.
- Jep përgjegjësi dhe llogari për punë e kryer dhe duhet të jetë i disiplinuar në punë duke respektuar rregulloret.
- Kryen edhe detyra tjera që lidhen me përshkrimin e detyrave të punës si dhe detyrave të ngarkuara nga Udhëheqësi i mirëmbajtjes.
- Për punën e vetë i jep raporte me shkrim tek inxhinieri,
- I raporton inxhinierit të makinerisë.

Kriteret dhe Dokumentacioni i kërkuar:

1. Shkolla e mesme apo fillore;
2. Aplikacionin për punësim;
3. Kopje të letërnjoftimit;
4. Përvojë pune përparësi;
5. Dëshmi mbi përvojën e punës.

4.Detyrat dhe përgjegjësitë – Autongjyrosës

- Pas pranimit të detyrave nga udhëheqësi i garazhe, angazhohet në kryerjen e detyrave për riparimin dhe ngjyrosjen e autobusëve nga aksidentet e krijuar dhe kthimin e gjendjes së mëparshme.
- Bën riparimin gjeneral dhe riparimet tjera të konstruksionit të jashtëm, gjegjësisht shasiesë së autobusit që janë në pritje për riparim duke u bazuar në urdhëresa për punë.
- Ndërrimin e profileve të pjesës së poshtme të autobusit, duke i vendosur në vijën boshtore të autobusit, riparim dhe ngjyrosje të autobusit, saldimit me gazë dhe hark elektrik të çelikut, gizes, aluminit, bakrit dhe elementeve me përbërje konstruktive,
- Ngarkohet me pjesë dhe vegla pune, të cilat i ka kërkuar nga depoja si dhe pajisje të tjera, duke respektuar procedurat e pranim dozimit,
- Bashkë me inxhinierin riparon dhe merr pjesë të drejtpërdrejt në riparim dhe identifikon problemin lidhur me aksidentin , të gjitha punët e kryera duhen të përcillen me proceduar përkatëse,
- Është përgjegjës për riparim dhe me ngjyrosje të shpejt dhe profesional të autobusëve, e tij,
- Kontrollon gjendjen ne hapësirën e punës dhe është përgjegjës për pastërti në punishte,
- Regjistron harxhimin e materialit dhe pjesëve rezervë dhe është përgjegjës për to si dhe bën porosi të materialit dhe ngjyrës sa i përket natyrës se punës, bën arsyeshmërinë e montimit e çdo pjese, kujdeset për kursimin e materialit, duke respektuar procedurat përcjellëse,
- Jep përgjegjësi dhe llogari për punë e kryer dhe duhet të jetë i disiplinueshëm në punë duke respektuar rregulloret,
- Mbanë evidencën për çdo autobusë që ka aksidentuar dhe e mban evidencën në mënyrë profesionale, shënimin e km se kur ka intervenuar në autobusë, kontrollon dhe vërteton çdo defekti në autobusë,
- Kryen edhe detyra tjera që lidhen me përshkrimin e detyrave të punës si dhe detyrave të ngarkuara nga Udhëh. Mirëmbajtjes.
- Për punën e kryer i jep raport me shkrim te inxhinieri,
- I raporton inxhinierit të makinerie,

Kriteret dhe Dokumentacioni i kërkuar:

1. Shkolla e mesme apo fillore;
2. Aplikacionin për punësim;
3. Kopje të letërnjoftimit;
4. Përvojë pune përparësi;
5. Dëshmi mbi përvojën e punës

5.Detyrat dhe përgjegjësitë – Depoist ndërrimi

- Udhëheqë evidencën e pranimit dhe shpërndarjen e të gjitha materialit për nevojat e TU (materialin e zyrave, pjesë të ndryshme të autobusëve, vajrat, yndyrat karburante) etj sipas nevojës.
- Përgatit raport ditorë, javor dhe mujorë për çdo shpenzim dhe shpërndarje të materialit, shpenzimet e karburanteve dhe vajrave në autobus si dhe shpërndarjen e

materialit për zyre dhe nevojave tjera, shpërndarjen e pjesëve rezervë të autobusëve.

- Furnizimin e depoz me material, pjesë rezervë dhe pjesë tjera sipas nevojë e ndërmarrjes bëhet vetëm në bazë të urdhëresës së udhëheqësit të njësisë apo të menaxherit ose personit të autorizuar duke i respektuar procedurat.
- Regjistron harxhimin e materialit dhe pjesëve rezervë dhe është përgjegjës për to, bën arsyeshmërinë e shpërndarjes të çdo pjese, kujdeset për kursimin e materialit,
- Përgjegjës për punë dhe disiplinë në punë,
- Kryen edhe detyra tjera që lidhen me përshkrimin e detyrave të punës si dhe detyrave të ngarkuara nga Udhë. Mirëmbajtjes.
- Për punën e vetë i jep raport javorë me shkrim te Udhë. Mirëmbajtjes dhe inxhinierit

Kriteret dhe Dokumentacioni i kërkuar:

1. Shkolla e mesme apo fillore;
2. Aplikacionin për punësim;
3. Kopje të letërnjoftimit;
4. Përvojë pune përparësi;
5. Dëshmi mbi përvojën e punës

6. Detyrat dhe përgjegjësitë - Shofer Autobusi

- Shoferi do të ngarkohet me fletë ngarkesë për automjetin – autobusin të cilin e drejton.
- Drejton autobusin sipas orarit të përpiluar nga udhëheqësi i Transportit të ndërmarrjes.
- Ti respektoj standardet e shërbimit, urdhrat e dispeçerit kryesorë dhe dispeçerit në pika nga terreni.
- Është përgjegjës për gjendjen teknike dhe paraqitjen e problemeve nga terreni, pastërtinë, furnizimin me karburante dhe lubrifikante.
- Pranon dhe zbret pasagjeret në të gjitha stacionet e caktuara sipas rendit të udhëtimit në linjat e legalizuara të "Trafikut Urban" duke respektuar standardet e shërbimit.
- Është i obliguar që para fillimit të orarit të punës të lajmërohet në punë, për të kontrolluar ujën, vajrat, karburantet, sistemin e ajrit dhe defektet – gërvishtjet tjera eventuale në autobus dhe para daljes në vijë të marrë pëlqimin është obligative – fletëurdhëresën e punës nga kontrollori teknik, se autobusi është i gatshëm të dal në vijë.
- Plotëson urdhëresën e udhëtimit sipas rregullave të përcaktuara nga TU.
- Është përgjegjës për ruajtjen e autobusit, motorit, dhe pajisjeve tjera të autobusit.
- Nëse konstatohet që nga pakujdesia e shoferit se autobusi ka pasur dëme, atëherë përgjegjësinë do ta bartë vet shoferi.
- Shoferi është përgjegjës në respektimin e rregullave të komunikacionit duke u bazuar në ligj mbi sigurinë në komunikacion, duke u bazuar në autobusin se a është teknikisht në rregull.
- Shoferi mbanë përgjegjësin nëse konsumon alkool para dhe gjatë vozitjes, nëse konstatohet nga instancat përgjegjëse.
- Shoferi ka për obligim që defektet në autobus ti lajmëroj me kohë me shkrim si dhe të nënshkruan urdhëresën e pranimit të autobusit të riparuar, (nëse nuk urdhërohet që të drejtoj ndonjë autobusë tjetër rezervë).
- Shoferi ka të ndaluar pirjen e duhanit dhe alkoolit në autobus dhe është i obliguar që edhe pasagjerëve tua ndaloj këtë.
- Nëse për shkaqe shumë të arsyeshme nuk mund të vij në punë, që të mos mbetet vija pa u mbuluar është i obliguar që me kohë ta lajmëroj Udhëheqësin e Transportit apo dhe të dëshmoj arsyeshmërinë e mos ardhjes në punë.
- Pas përfundimit të orarit të punës është i obliguar të sjell autobusin në bazë dhe të njoftoj kontrollorin teknik për defektet eventuale në autobus, në të kundërtën të nesërmen nëse autobusi nuk del në vijë për shkak të defektit, përgjegjës është shoferi paraprak që se ka lajmëruar defektin.
- Në rast të ndonjë aksidenti, është i obliguar të thërras Policinë, të bëj foto të aksidentit dhe të njoftoj bazën.
- Shoferi e ka të ndaluar të ngasë autobusin në mungesë të konduktorit.
- I raporton U.T.

Kriteret dhe Dokumentacioni i kërkuar:

1. Shkolla e mesme apo fillore;
2. Aplikacionin për punësim;
3. Kopje të letërnjoftimit;
4. Patentë shofer – Kategoria D;
5. Përvojë pune përparësi; (ngasja në trafik urban përparësi)
6. Dëshmi mbi përvojën e punës
7. Së paku 21 vjeç.

7. Detyrat dhe përgjegjësitë - Diçeçer Linje

- Mban evidencën ditore të shoferëve dhe konduktërëve në harmoni me orarin ditore dhe mujor.
- Kujdeset mbi mirëmbajtjen e rregullave të nisjeve sipas orarit dhe siguron linjën e operimit.

- Në rast të mungesës së autobusëve të mjaftuar në linje, kontakton me dispeçerit e bazës dhe monitoruesin për ti ofruar ndihmë me autobus.
- Bënë nënshkrimin e urdhëresave të punës në fillim dhe mbarim të çdo turre, është përgjegjës për nënshkrimet e bëra në urdhëresë.
- I njëjti në shërbimin ekonomik financiar furnizohet me bileta mujore sipas nr. serik dhe mban përgjegjësi me biletat e ngarkuara sipas nr. serik.
- Është i obliguar që me bileta mujore ti furnizoj pasagjerët sipas grup moshave-profesionit dhe çmimeve në to (nxënës, studentë, dhe punëtorë).
- Është i obliguar që nga pasagjerët të kërkoj dokumentacionin përkatës – fotografi, vërtetim etj.
- Është i obliguar që për çdo biletë të dhënë mujore të evidentoj pasagjerin në librin e posaçëm.
- Është i obliguar që për çdo ditë në arkën e ndërmarrjes – te arkëtari të dorëzoj pazarin ditore për bileta të shitura.
- Kryen edhe punë të tjera me urdhër të Udhëheqësit të Transportit dhe Drejtorit të operatives.
- I raporton U.T.

Kriteret dhe Dokumentacioni i kërkuar:

1. Shkolla e mesme apo fillore;
2. Aplikacionin për punësim;
3. Kopje të letërnjoftimit;
4. Përvojë pune përparësi;
5. Dëshmi mbi përvojën e punës

8. Detyrat dhe përgjegjësitë - Punëtor Sigurimi

- Kryen sigurimin e objekteve dhe pasurisë së ndërmarrjes në përgjithësi.
- Gjatë pranimit-dorëzimit të detyrës në libër të veçantë mban evidencë mbi vërejtjet që ka gjatë orarit të tij të punës.
- Siguron me përpikëri tërë pasurinë e ndërmarrjes dhe asaj që gjendet në vendin në të cilin ruan gjatë ndërrimit të tij.
- Nuk e lejon prezencën e njerëzve të pa autorizuar gjatë natës në objektet e ndërmarrjes.
- Udhëheqë librin e evidentimit mbi hyrjen dhe daljen nga lokacioni i ndërmarrjes : të automjeteve, punëtorëve dhe personave të tjerë duke ua marrë këto shënime: datën dhe kohën e hyrjes, gjegjësisht daljes, emrin dhe mbiemrin e personit i cili ka hyrë në lokacion, gjegjësisht që del nga oborri i ndërmarrjes, a është person i ndërmarrjes a person i jashtëm, nr. e regjistrimit të automjetit që ka hyrë në lokacion, gjegjësisht që del nga lokacioni i ndërmarrjes duke evidentuar kohën e hyrjes dhe daljes.
- Në rast të ndonjë parregullsi gjatë procesit të punës mund të kërkon ndihmë nga policia nëse është i penguar gjatë kryerjes së detyrës.
- Është përgjegjës për krejt atë çka humb në ndërmarrje gjatë ndërrimit të tij.
- Duhet të sigurojë, kontrollojë të gjitha pajisjet apo depot se a janë të mbyllura kur e pranon detyrën, a janë parkuar mirë të gjithë autobusët, në mënyrë që mos të pengojnë asnjë punëtorë gjatë kryerjes së detyrës.
- Pas çdo ndërrimi duhet të raportoj Udhëheqësin e Sigurimit për atë që ka ndodhur gjatë ndërrimit e në raste serioze edhe Kryeshefin Ekzekutiv të ndërmarrjes.
- Gjatë kryerjes së punës dhe detyrave të caktuara është i obliguar që të sillet në pajtim me dispozitat e rregulloreve të ndërmarrjes dhe Kodit të Mirësjelljes dhe Etikës, në të kundërtën do të merrën masa përgjegjësie të përcaktuara me Rregulloren mbi Përgjegjësinë Disiplinore dhe Materiale të Ndërmarrjes.

Kriteret dhe Dokumentacioni i kërkuar:

1. Shkolla e mesme apo fillore;
2. Aplikacionin për punësim;
3. Kopje të letërnjoftimit;
4. Përvojë pune përparësi;
5. Dëshmi mbi përvojën e punës
6. Certifikata relevante - përparësi

Informata të përgjithshme:

-Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjitha qytetarët pa dallim.

-Ndërmarrja ofron mundësi të barabarta, inkurajon dhe promovon angazhimin e punëtorëve, pjesëtarë të të gjitha komuniteteve dhe të gjinive të ndryshme.

Konkursi është i hapur nga data **12.10.2019** dhe përfundon më datë **26.10.2019** në ora 16:00.

Kryeshefi Ekzekutiv
Lulzim Rexhepaj

NPK "Trafiku Urban" SHA

Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë - Kosovë

web: www.trafikurban-pr.com email: info@trafikurban-pr.com tel: +383 45 10 11 23



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Në bazë të nenit 57 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shendetësor, Nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, si dhe nenin 4 dhe 5 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 07/2017 për Rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik, Oda e Mjekëve të Kosovës shpall këtë:

KONKURS

ASISTENT/E ADMINISTRATIV/E PRANË ODËS SË MJEKËVE TË KOSOVËS

Numri i pozitave: 1 (një vend pune),

Nr. ref: 04/2019

Kohëzgjatja e Kontratës: Kohë të pacaktuar

Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Ofron asistencë në kryerjen e punëve administrative për nevojat e punëve pranë organeve të OMK-së;
- Pranon aplikacionet, kërkesat/ankesat nga palët drejtuar organeve të OMK-së, kujdeset për mbarëvajtjen e procedurës administrative deri në shqyrtimin final të lëndës;
- Mirëmbanë dosjet, në formën fizike dhe elektronike si dhe data bazën e organeve të OMK-së;
- Siguron materialet e nevojshme për mbarëvajtje të mbledhjeve të organeve të OMK-së;
- Ndihmon anëtarët e organeve të OMK-së në kontaktet e ndërsjella si dhe në raport me palët e treta;
- Kryen edhe punë tjera nga fusha e përgjegjësisë dhe specifikimeve të përcaktuara me Kontratën e Punës.

Shkollimi i kërkuar: Diplomë Universiteti Bachelor në fushën Juridik, Administratë Publike, Ekonomi, Banka, Financa dhe Marketing

Aftësitë / përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen:

- Aftësi për zbatimin e procedurave dhe udhëzimeve administrative për kryerjen e detyrave të punës;
- Së paku 1 vit përvojë pune;
- Njohja e gjuhës angleze konsiderohet përparësi;
- Njohje e mirë e punës me kompjuter Word, Excel, Internet dhe mjeteve tjera teknike në zyrë;
- Të ketë aftësi të punës ekipore dhe aftësi për të krijuar raporte pune ndër personale të shkëlqyeshme;
- Shkathësi të dëshmuara dhe efektive të komunikimit me gojë dhe shkrim;
- Shkathësi komunikimi, përfshirë aftësinë për të interpretuar informata, për të dhënë udhëzime dhe për të përcjellë informata tek të tjerët;
- Të jetë energjik/e, të jetë i/e gatshme të punojë nën presion dhe me orar fleksibil të punës;
- I/e aftë të mbajë informatat konfidenciale në mënyrë të përshtatshme;
- Personalitet të përkushtuar, me iniciativë, aftësi dhe vullnet për të marrë përgjegjësi.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim: Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë shkollimin e kërkuar dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave.

Paraqitja e kërkesave:

Inkurajohen të gjithë kandidatët e interesuar të cilët i plotësojnë kushtet e cekura më lartë të aplikojnë. Formularët për aplikim mund të shkarkohen nga ueb faqja zyrtare e OMK-së www.omk-rks.org.

Aplikacionet e plotësuara së bashku me kopjen e letërnjoftimit, kopjet e dëshmimeve për kualifikimet e nevojshme arsimore, përvojën e punës, kurset e ndjekura, referencat si dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme të kërkuara sipas kushteve të konkursit, mund të dorëzohen:

- Përmes e-mail adresës: info@omk-rks.org, dhe
- Përmes postës në adresën: Oda e Mjekëve të Kosovës, QKUK INSTITUTI A Kati III, 10 000 Prishtinë.

Në aplikacion duhet të ceket qartë titulli i vendit të punës dhe dokumentet e bashkëngjitura aplikacionit duhet të jenë kopje meqë të njëjtat nuk kthehen.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë dhe aplikacionet e pakompletuara nuk do të shqyrtohen.

Aplikacionet e dërguara me post të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim, nëse arrijnë brenda ditëve sa shpallja mbetet e hapur.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë, nga dita e publikimit dhe do të jetë i hapur nga data: 12.10.2019 deri më 26.10.2019.

Për informata shtesë mund të kontaktoni në numrat e telefonit: 049/872-300 apo 038 / 544-872.

Konkursi dhe kërkesa për punësim janë të publikuara edhe në Ueb-Faqen e Odës: <https://omk-rks.org/>

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientet së kompania "MERVE PHARM" SHPK, me seli në Prizren ka marr vendim të shuajë biznesin me numër fiskal 810023424 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvelimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientet që kanë raporte Kreditorë - Debitore në këtë shoqëri që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazete.

OBAVESTENJE

Obaveštavamo se svi klienti da Tvrtka "MERVE PHARM" D.o.o. u Prizrenu, doneo odluku ka ugasi biznis sa fiskalnom brojem 810023424, i ujdno imenovao Likfidatora o sprovedenju postupka likvidacije. Obaveštavaju se svi klienti imaju obaveze i potraživanja u navedenjo firmi, da se jave u roku od 30 dana od objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the Company "MERVE PHARM" L. L .C. in Prizren has come to the decision to quit its business and with the fiscal number 810023424. The company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager -mmortgage accounts in this company are kindly request to show up with in 30 days starting from the day of newspaper announcement publication.

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Llullat, Rr. Bajram Kelmendi

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientet së kompania "MERVE PHARM" SHPK, me seli në Prizren ka marr vendim të shuajë biznesin me numër fiskal 810023424 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientet që kanë raporte Kreditore - Debitore në këtë shoqëri që të paraqiten në afatin 30 ditore nga data e shpalljes në gazete.

OBAVESTENJE

Obaveštavamo se svi klienti da Tvrtka "MERVE PHARM" D.o.o. u Prizrenu, doneo odluku ka ugasi biznis sa fiskalnom brojem 810023424, i ujdno imenovao Likfidatora o sprovedenju postupka likvidacije. Obaveštavaju se svi klienti imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the Company "MERVE PHARM" L. L. C. in Prizren has come to the decision to quit its business and with the fiscal number 810023424. The company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage accounts in this company are kindly request to show up with in 30 days starting from the day of newspaper announcement publication.

RESTAURANT

SWISS
TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

Prishtinë



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpejite

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Bajram Deliu, shpall të pavlefshme Diplomën e SHF "Malush Ahmeti" Rezalle.

► Avni Selimi shpall të pavlefshme Dëftesat e SHF "Ali Kelmendi" Leqine.

► Rustem Musliu shpall të pavlefshme Dëftesën e SHF "Emin Duraku" Likoc.

► Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m², kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotësor të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qera në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanë me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira në qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajazitit, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m². Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m², dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira, në lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroji i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

► Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo, ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet. Për info: 045/699-221.

► Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qerimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.

► Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783

► Lëshoj banesë me qira në Ulpianë, tek Fontana në: E 30-3A, nr.27, kati -IV-. Çmimi sipas marrëveshjes në info: 044-132-368.

► Kërkoj dy bashkëbanuese, mundësisht të cilat janë duke punuar. Banesa gjendet në qendër të qytetit në Prishtinë përball Prokurorisë së shtetit (ish-ndërtesa e OSBE-së, ose ish-ndërtesa e Bankës së Lubjanës), rruga "Hajdar Dushi", afër shtabit kryesor të Policisë së Kosovës. Banesën mund ta shihni çdo ditë. Numri i telefonit: 049/402-518.

► Shesim banesën dy dhomshe në Ulpiana D8 h3 Nr 15 kati 3 ndërtim i vjetër, e rinovuar komplet, me nxemje të qytetit, çmimi 77 000€. Informatat tel:049/400-958 dhe 044/627-387

► Lëshoj banesën e pamobiluar (garsonierë) me qira. Banesa, e cila gjendet rrugës për në Gërmi, 150 metra afër Kolegjit Amerikan A.U.K, ndodhet në katin 5. Çmimi 130 euro. Tel: 049/705-503 dhe 049/662-211.

► Lëshoj garsonierën me qira 13 m² kati i IV (katër) në Lagjen Ulpiana. Çmimi 150 euro. Për info: 044/637-546.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Ulpiana objekti C7 kati i 3 hyrja e II-të nr 11 ka 50 m² dy dhomshe, një banjo, kuzhinë të gjitha të reja, është e përshtatshme për zyre edhe apo ordinancë. Për informata në tel; 044/641-524 dhe + 46705793508.

► Kërkoj punëkryes për ndërtimin e serres 4000 metra katrorë. Shefqet Shala, B.I-Skenderaj. Tel.044-499-713.

► Kërkoj punëkryes për ndërtimin e serres 4000 metra katrorë. Hasan Osmani, B.I-Skenderaj. Tel. 044-355-579.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

RC COLA
Columbus, Georgia, USA
Since 1909